

Plani Kombëtar i Veprimit

për Personat me Aftësi të Kufizuara

2016 -2020





Republika e Shqipërisë
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara

2016-2020

Qershor 2016

Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 483, datë 29 qershor 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



United Nations
ALBANIA



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrinë e linjës, në konsultim të ngushtë me autoritetet vendore, si dhe me pjesëmarrjen aktive të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile.

FJALË PËRSHËNDETËSE

Qëllimi i këtij Plani Veprimi të Qeverisë shqiptare është të nxisë përfshirjen e personave me Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, është hartuar në përputhje të plotë me parimet themelore të Konventës Ndërkombëtare për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe Strategjinë e Bashkimit European për Personat me Aftësi të Kufizuara, në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë.

Motoja e Konventës së OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara “Asgjë për Ne, pa Ne”, na udhëhoqi gjatë gjithë procesit të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2016-2020. Ky dokument strategjik i aftësisë së kufizuar, për herë të parë, u bashkëhartua tërësisht me grupin e interesit. Pjesëmarrja aktive e përfaqësuesve të të gjitha kategorive të Aftësisë së Kufizuar në grupin e punës që hartoi Planin, i dha këtij dokumenti jetë e vërtetësi, duke nxjerrë në pah nevojat reale, por edhe barrierat ekzistuese me të cilat përballen në Shqipëri individët me aftësi të kufizuar.

Vendimi i Qeverisë konfirmon edhe njëherë përkushtimin e saj për të bërë realitet integrimin dhe përfshirjen e PAK në shoqëri duke e konsideruar këtë kategori si një nga grupet më vulnerabël e të përjashtuar të shoqërisë. Edhe pse masat e ndërmarra deri tani, tregojnë për vëmendje në rritje të qeverisë dhe përgjegjësisë së institucioneve shtetërore, jemi të ndërgjegjshëm që kemi ende shumë për të bërë dhe sfidat me të cilat duhet të përballemi janë ende të mëdha.

Qeveria është e bindur se zbatimi i politikave mbështetëse për këtë grupim duhet të marrë një vend të rëndësishëm në axhendën politike të 5 viteve të ardhshme.

Qeveria është e bindur se zbatimi i politikave integruese për personat me aftësi të kufizuar do ta shndërrojë këtë grupim në një potencial të vërtetë për shoqërinë shqiptare.

Si në asnjë dokument tjetër të mëparshëm, një theks të vecantë kanë politikave dhe masat konkrete për të realizuar një arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar që ata kanë. Vizioni ynë për vitin 2020 është që çdo fëmijë me Aftësi të Kufizuara të jetë përfshirë në arsimin bazë dhe numri i të rinjve me Aftësi të Kufizuara që ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë të jetë rritur.

Një vend të veçantë zenë politikave e punësimit nëpërmjet programeve të posaçme të nxitjes së punësimit dhe programeve të aftësisimit profesional për këtë kategori.

Për të rritur e përmirësuar cilësinë e shërbimeve sociale dhe atyre shëndetsore, por edhe të ardhurat në funksion të përmirësimit të jetesës, Plani për herë të parë, parashikon ndërhyrje të rëndësishme në vlerësimin sipas modelit bio-psiko-social dhe jo vetëm të atij mjekësor sikundër është aplikuar deri tani.

Parashikimi i të gjitha buxheteve të nevojshme për realizimin e masave të Planit tregon përgjegjësinë që kjo Qeveri merr përsipër duke u angazhuar seriozisht që jeta e Personave me Aftësi të Kufizuara në 5 vitet e ardhshme të jetë më e mirë e më e denjë.

Për realizimin me sukses të procesit të hartimit të këtij Plani , dëshëroj të falenderoj në mënyrë të veçantë të gjitha organizatat e shoqërisë civile dhe çdo individ me aftësi të kufizuar të përfshirë, të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera të Qeverisë, institucionet e pavaruara si Avokati i Popullit dhe Komisioneri Kundër Diskriminimit, për kontributin e tyre në shkrimin e këtij dokumenti, por edhe për mbrojtjen e vazhdueshme të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Një falënderim i veçantë shkon për partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht PNUD-in, për ndihmesën e tyre në finalizimin e këtij dokumenti të rëndësishëm.

Ne vlerësojmë dhe sigurojmë bashkëpunimin tonë me të gjithë partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë , për të bërë të mundur jetësimin e angazhimeve dhe masave të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, 2016-2020.

Blendi KLOSI

Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë



TABELA E PËRMBAJTJES

	Hyrje	9
1.	Kushtet aktuale	17
1.1	Aksesueshmëria	18
	<i>1.1.1 Aksesueshmëria fizike</i>	19
	<i>1.1.2 Akses në informacion</i>	22
1.2	Barazia	23
1.3	Punësimi dhe AFP-ja	26
1.4	Arsimimi	29
1.5	Kujdesi social	32
1.6	Kujdesi shëndetësor	36
1.7	Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike	38
1.8	Bashkëpunimi rajonal, monitorimi dhe vlerësimi	40
2.	Vizioni, politikat dhe qëllimet strategjike	43
3.	Objektivat e politikave dhe produktet kryesore	47
4.	Burimet financiare	57
5.	Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza e vlerësimit	63
5.1	Llogaridhënia	63
5.2	Monitorimi i Planit të Veprimit	65
5.3	Mbledhja e të dhënave	67
6.	Matrica e Planit të Veprimit	73
	Shtojca 1 – Bibliografia	144



AKRONIME

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ALSHISH	Agjencia për Livrimin e Shërbimeve të Integruara në Shqipëri
AZBZH	Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
BB	Banka Botërore
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
DPPS	Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale
GTIS	Grupi i Treguesve dhe Integritetit të Statistikave
ISHPSHSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MIAP	Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike
MK	Ministria e Kulturës
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NLF	Ndihmë Ligjore Falas
NJMF	Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë joqeveritare

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PAK	Person me aftësi të kufizuara
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PSBGJ	Përfshirja Sociale dhe Barazia Gjinore
SESIMS	Sistemi Evropian i Statistikave të Integruara të Mbrojtjes Sociale
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e tabelave

Tabela 1	Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në nivele të ndryshme arsimore, 2013-2014 dhe 2014-2015
Tabela 2	Përdorimi i kuotave për nxitjen e aksesit në arsimin e lartë
Tabela 3	Ndihma ekonomike për familjet që kanë një person me aftësi të kufizuara
Tabela 4	Numri i përfituesve me aftësi të kufizuara dhe buxheti i shtetit 2009 dhe 2013
Tabela 5	Numri i përfituesve në qendrat publike dhe jopublike rezidenciale dhe të kujdesit ditor
Tabela 6	Tabela matricë për Planin e Veprimit

Lista e figurave

Figura 1	Numri i aksidenteve të rënda rrugore, 2009-2014
Figura 2	Ndryshimi i numrit të përfituesve me aftësi të kufizuara dhe buxheti i shtetit 2009 dhe 2013
Figura 3	Përfituesit e qendrave të kujdesit rezidencial dhe ditor





♿ HYRJE



HYRJE

Qëllimi i këtij Plani Veprimi të Qeverisë shqiptare është të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre. Pas ratifikimit të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012¹ dhe pas marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE në vitin 2014, qeveria përgatiti një Dokument Politikash për Përfshirjen Sociale (DPPS 2016-2020). DPPS-ja garanton një sistem për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në fushat e politikave, si ulja e varfërisë dhe mbrojtja sociale, punësimi dhe aftësitë, arsimimi dhe trajnimi, shëndetësia, nevojat bazë, pjesëmarrja dhe të drejtat e njeriut. Ajo nxit transparencën dhe llogaridhënien për mënyrën sesi matet dhe si përdoret përfshirja sociale për të dhënë informacione për zbatimin e shërbimeve publike.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara është përgatitur në bashkëpunim me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizata të tjera të shoqërisë civile që promovojnë të drejtat e këtij grupi, me komunitetin ndërkombëtar dhe me njësi të qeverisjes vendore. Plani i Veprimit mbulon periudhën 2016-2020.

Sipas Konventës së OKB-së, "persona me aftësi të kufizuara janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët"². Censusi 2011 në Shqipëri nxori në pah se 6,2% e popullsisë mbi moshën 15 vjeç³ (2 084 137 persona) vuan nga një formë e aftësisë së kufizuar⁴. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vlerëson se në nivel botëror, personat me aftësi të kufizuara përbëjnë 15% të popullsisë dhe na kujton se aftësia e kufizuar është pjesë e gjendjes njerëzore, duke qenë se pothuajse çdokush nga ne do të vuajë përkohësisht apo përgjithmonë nga një e tillë në një pikë të caktuar të jetës⁵.

Prevalenca e aftësive të kufizuara lidhet ngushtë me moshën, meqenëse aftësitë e kufizuara janë më të pakta në moshat e reja (burra dhe gra), nën 3%, dhe arrin në 6% në popullsinë e grupmoshës 50-64 vjeç. Nivelin rritet në vlerën 20% për burrat mbi 65 vjeç dhe 25% për gratë e së njëjtës grupmoshë. Në të dhënat e tjera treguese përfshihet numri i personave që përfitojnë pagesa të aftësisë së kufizuar⁶ i cili ishte 139 130 në vitin 2013 dhe 143 516 në vitin 2014⁷.

1 Konventa u ratifikua nga Parlamenti i Shqipërisë në vitin 2012 dhe hyri në fuqi më 1 shkurt 2013.

2 Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 1.

3 Censusi nuk jep të dhëna për personat nën 15 vjeç.

4 Persona që e identifikojnë veten si persona me vështirësi/dëmtime serioze ose ekstreme në të paktën një nga të mëposhtmet: shikim, dëgjim, lëvizje, dëmtime shqisore, kujdesi ndaj vetes dhe komunikim.

5 OBSH, *Raporti Botëror për Aftësitë e Kufizuara*, 2011, faqe 3 dhe 27.

6 Sipas një vlerësimi të Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë.

7 Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, *Rishikimi i raporteve të dorëzuar nga shtetet palë bazuar në nenin 35 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, draft raporti i parë, 2015, f. 7.*

Plani i Veprimit u hartua në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”:

1. *Mosdiskriminimi*, i cili garanton që personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
2. *Barazia, përfshirë barazinë gjinore*, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;
3. *Autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara*;
4. *Garantimi i aksesueshmërisë* nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve;
5. *Përfshirja*, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;
6. *Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara* nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;
7. *Qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t'i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete*;
8. *Realizimi progresiv*, sipas të cilit qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Meqë Konventa e OKB-së është ratifikuar me ligj, ajo mbizotëron kur legjislacioni i brendshëm bie në kundërshtim me normat e saj. Për periudhën në vijim, qeveria do të fokusohet në harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me standardet dhe parimet e parashikuara në konventë, duke u fokusuar në deinstitutionalizim, përmirësimin e pjesëmarrjes, decentralizimin e shërbimeve dhe luftën kundër diskriminimit. Plani i Veprimit parashtron këto lloje aktivitete në fushat e mëposhtme:

- Aksesueshmëria (përfshirë aksesueshmërinë fizike dhe atë në informacion),
- Barazia,
- Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP),
- Arsimimi,
- Kujdesi social,
- Kujdesi shëndetësor,
- Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike (përfshirë aktivitetet kulturore dhe sportive),
- Nxitja e bashkëpunimit, koordinimit dhe Monitorimit e Vlerësimit.



Fushat prioritare janë përcaktuar sipas fushave të identifikuar në Strategjinë Evropiane për Aftësitë e Kufizuara. Qeveria është e angazhuar që të përmirësojë pozicionin e personave me aftësi të kufizuara dhe aksesin në të drejtat e tyre në të gjitha sferat e jetës.

Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministrinë përkatëse të linjës. Në disa raste, buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, kështu që Plani i Veprimit përfshin një ndarje të hendekut të financimit si dhe propozimin për fonde donatorësh. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për nxitjen e përfshirjes në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në këtë Plan Kombëtar Veprimi, i cili fokusohet në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore.

Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara do të monitorohet nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (si organi koordinues) dhe zyrtarët përkatës në ministrinë e linjës. Grupi Tematik për Përfshirjen Sociale (brenda Grupit Qeveritar për Menaxhimin e Integruar të Politikave - Punësimi, Aftësitë dhe Politikat Sociale) do të vendosë një Grup të Treguesve dhe Integritetit të Statistikave (GTIS) për të garantuar respektimin e standardeve të të dhënave për të gjithë treguesit në nivel BE-je dhe në nivel kombëtar.

Do të kryhet një monitorim i jashtëm nga organizata të personave me aftësi të kufizuara, organizata të tjera të shoqërisë civile, Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe komuniteti ndërkombëtar. Zbatimi i suksesshëm i Planit të Veprimit do të varet nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore dhe shoqërinë civile.

Metodologjia

Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2016-2020 u hartua nga Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës i ngritur nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar i ngritur me Urdhër Nr 12 datë 9.02.2015 të Kryeministrit. Ai u hartua përmes një procesi të gjerë konsultimi ku morën pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, kryesisht ato të personave me aftësi të kufizuara dhe komuniteti ndërkombëtar.

Metodologjia për hartimin e Planit të Veprimit konsistoi në:

1. *Fazën përgatitore, gjatë së cilës u zhvilluan takime individuale prezantuese me antarët*

e GNTP në të gjitha ministritë e linjës me qëllim njohjen e procesit të hartimit të Planit të Veprimit dhe marrjen e mendimeve të tyre lidhur me situatën aktuale në cdo sektor. Grupe të fokusuara me përfaqësues të organizatave të PAK, me qëllim njohjen e procesit si dhe shprehjen e interesit të tyre për pjesëmarrje në seminarët sektoriale si pjesë e grupit të punës. Në të njëjtën kohë, një analizë e strategjive ekzistuese, të dokumentave zyrtare dhe raporteve u ndërmorrën me qëllim për të grumbulluar informacion rreth rezultateve të aktiviteteve të shkuara, shëmbujve të praktikave të mira dhe mësimëve të marra, si dhe të sigurohej që Plani i Veprimit ishte i mirëvendosur me axhenden tërësore të Qeverisë.

2. *Zhvillimin e 5 Seminareve Sektoriale* me ministritë e linjës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përfshi anëtarë të shoqatave dhe individë PAK.
3. *Hartimi i draftit me asistencën teknike të një eksperti ndërkombëtar dhe një kombëtar, pasuar nga takimet individuale* me strukturat e buxheteve në ministritë e linjës (duke u fokusuar vecanërisht në grumbullimin e të dhënave të pikënisjes së këtij plani dhe hartimin e buxhetit të tij).
4. *Prezantimi publik* i draft dokumentit të Planit të Veprimit, diskutime dhe përfundime.

Pjesëmarrja e grupeve të interesit

Plani i Veprimit për PAK 2016 – 2020 është hartuar me kontributin e dhënë nga grupi teknik i punës i koordinuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me anëtarë dhe ekspertë të ardhur nga ministritë përkatëse të linjës, shoqëria civile dhe individë PAK. Gjatë hartimit të Planit të Veprimit janë konsultuar gjithsej rreth 250 individë nga grupet e interesit.

Për përgatitjen e draftit është ofruar ekspertizë dhe asistencë teknike nga Projekti “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri”, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ministritë e linjës

Pas takimeve prezantuese me ministritë përkatëse të linjës, u organizua një seminar sektorial i posaçëm nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me ministri të tjera të linjës dhe në bashkëpunim me përfaqësues nga shoqëria civile. Grupet e punës identifikuan nevojat dhe hartuan synimet, objektivat dhe aktivitetet në secilin sektor. Në vijim u organizuan konsultime me ministritë e linjës për mbledhjen e të dhënave bazë dhe përcaktimin e buxhetit.



Shoqëria civile duke përfshirë organizatat e PAK

Në 5 seminarët sektoriale të zhvilluara, së bashku me ministritë e linjës morën pjesë përfaqësues të organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara, ekspertë që punojnë në institucione të pavarura si Komisioneri Antidiskriminim dhe Avokati i Popullit, të cilët shprehën gjithashtu këndvështrimet e tyre në diskutimet me grupet e fokusuara. Gjatë këtyre seminareve u angazhuan të rinj të diplomuar me aftësi të kufizuara të ndryshme, u përfshinë si pjesë aktive e ekipit të konsulentëve që lehtësuan konsultimet, si dhe mbështetën hartimin e Planit të Veprimit.

Në takimin që Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizoi me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, ata dhanë informacione rreth aktiviteteve të tyre në të shkuarën dhe atyre aktuale, të cilat kanë shërbyer si frymëzim për disa nga masat e Planit të Veprimit. Këto organizata kanë dhënë gjithashtu një përshkrim të aktiviteteve që planifikojnë të kryejnë gjatë periudhës 2016-2020. Anketat dhe studime të tjera të publikuara nga organizatat ndërkombëtare në Shqipëri kanë qenë tepër të vlefshme për hartimin e Planit të Veprimit, për argumentimin dhe për përcaktimin e përparësisë së masave të ndryshme.



1



Kushtet Aktuale





1. KUSHTET AKTUALE

Ky seksion vlerëson progresin e realizimit të Strategjisë së mëparshme për Personat me Aftësi të Kufizuara, që mbulon periudhën 2005-2015 dhe të dokumenteve të tjera strategjike në këtë fushë⁸. Ai përshkruan gjithashtu kushtet aktuale në fushat ku personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me pengesa në aksesimin e shërbimeve dhe realizimin e të drejtave të tyre, dhe më konkretisht aksesueshmëria (duke përfshirë aksesueshmërinë informative dhe atë fizike), pjesëmarrja në jetën politike dhe publike (duke përfshirë të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, aktivitetet kulturore dhe sportive), barazia, punësimi dhe AFP-ja, arsimimi, kujdesi social, kujdesi shëndetësor, si dhe nxitja e bashkëpunimit, koordinimit dhe monitorimit e vlerësimit.

1.1 Aksesueshmëria

Aksesueshmëria, e përkufizuar si mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve⁹, përfshin disa aspekte të ndryshme:

- Akses fizik në objektet shtetërore, qendrat e shërbimit, hapësira të tjera publike (qendra tregtare, parkingje, plazhe publike dhe terrene sportive, qendra kulturore etj.) në rrugë dhe trotuare.
- Akses në informacion, përmes formateve të aksesueshme ose përmes ofrimit të shërbimeve online/në faqe interneti të aksesueshme.

Edhe strategjia e mëparshme kombëtare për personat me aftësi të kufizuara e pranonte rëndësinë e kësaj çështjeje dhe kishte për qëllim "të siguronte që vendet dhe ndërtesat e të gjitha agjencive qeveritare dhe zyra publike të ishin të aksesueshme"¹⁰. Megjithatë, Shqipëria ende përballlet me sfida të mëdha në eliminimin e pengesave. Gjithashtu, shumë ndërtesa publike dhe hapësira publike të jashtme dhe faqe interneti qeveritare nuk janë të aksesueshme. Personat me probleme në dëgjim pothuajse nuk kanë fare akses në shërbimet private ose publike duke përdorur gjuhën e shenjave.

Veprimet e nevojshme në këtë fushë shpesh janë përgjegjësi e njëjësive të qeverisjes vendore. Ky Plan Veprimi përcakton veprimtaritë në nivel kombëtar që janë përgjegjësi e qeverisjes qendrore. Megjithatë, do të nevojitet bashkëpunim dhe koordinim i ngushtë ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe shoqërisë civile, me qëllim që të sillen ndryshime të dukshme në këtë fushë.

⁸ Informacioni në këtë seksion bazohet gjerësisht në raportin e parë të progresit të qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përgatitur në maj 2015.

⁹ Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, neni 3.

¹⁰ Qeveria e Shqipërisë, *Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2005-2015*, objektivi 9.

1.1.1 Aksesueshmëria fizike

Lëvizja e pavarur në rrugë dhe në trotuare është pothuajse e pamundur për personat në karrige me rrota apo që përdorin shkop. Shumë pak trotuare janë përshtatur, ata mund të jenë të ngushtë dhe shpesh sipërfaqja e tyre nuk është e njëtrajtshme. Transporti publik mbetet i paaksesueshëm. Edhe pse qeveria ka miratuar standardet përkatëse, ata nuk zbatohen në praktikë.

Në kryqëzimet e rrugëve apo në transportim publik nuk ekzistojnë sinjalizimet zanore dhe stacionet e autobusit janë të pashënuar, duke e bërë orientimin të vështirë. Shumë pak rrugë dhe ndërtesa publike përfshijnë shenja të ngritura ose të përshtatura për të verbërit si dhe mungojnë mjetet ndihmëse si shkopinj të bardhë, qentë orientues dhe qentë ndihmës.

Ministria e Shëndetësisë ka vendosur që të gjitha **qendrat e reja spitalore/të kujdesit shëndetësor** duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe është duke akorduar fonde për përmirësimin e aksesueshmërisë së mjediseve që janë në rikonstrukcion. Gjithashtu, Njësitë e Qeverisjes Vendore, përgjegjëse për miratimin e planeve për infrastrukturën e objekteve shkollore, do të autorizojnë vetëm punime që plotësojnë standardet e aksesueshmërisë. Gjatë dhjetë viteve të fundit, objektivat e përcaktuara në Planin e mëparshëm të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara (për numrin e shkollave të aksesueshme, ambienteve parashkollore dhe qendrave të AFP-së¹¹) nuk u arritën.

Disa **ndërtesa qeveritare** janë të aksesueshme. Shumë të tjera po rikonstruktohen me qëllim që të garantojnë aksesueshmëri të plotë për PAK. Janë të pakët personat me aftësi të kufizuar të punësuar në institucione qendrore dhe vendore.

Aspektet kryesore të së drejtës për **strehim** të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara përfshijnë aksesueshmërinë fizike të banesës, banesën me shërbime mbështetëse, strehimin social dhe subvencionet. Personat me aftësi të kufizuara mund të marrin me qira apo të blejnë vetëm një numër të vogël banesash dhe apartamentesh që nuk kërkojnë shpenzime shtesë për përmirësimin e aksesueshmërisë (p.sh. duke ndërtuar rampa, duke zgjeruar hapësirat e hyrjeve, duke ulur lartësinë e çelësave të dritave, etj.). Në vitin 2008, Këshilli i Ministrave nxori një vendim "Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara", i cili parashikon standardet e aksesueshmërisë dhe normat që duhet të zbatohen në industrinë e ndërtimit (veçanërisht në lidhje me aksesin nëpër ndërtesa, rrugë dhe mjedise të tjera të brendshme dhe të jashtme). Në ndërtimet publike si banesat sociale me qira dhe banesat me kosto të ulët, këto te fundit ndërtuar nga EKB, janë patur parasysh dhe janë zbatuar këto standarde. Megjithatë, këto standarde nuk mbikëqyren në mënyrë sistematike dhe zbatimi i tyre nuk monitorohet.

¹¹ Në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2005-2015, qeveria u angazhua të bëjë të aksesueshme 100 shkolla, 90 kopshte dhe tetë qendra AFP (Aktiviteti 1.4).



Qeveria ofron disa programe për strehimin që përfshijnë banesa sociale me qira, banesa me kosto të ulët dhe truall të pajisur me infrastrukturë¹². Përveç kësaj, programet e mësipërme janë mbështetur nëpërmjet instrumentave financiare për ofrimin e strehimit social sic janë bonuset e strehimit, subvencione qiraje, subvencionim të kredisë, grant i menjëhershëm për banesa me kosto të ulët deri në 10 % të vlerës së banesës. Gjithashtu, duhet theksuar se personat me aftësi të kufizuara përfitojnë kushte favorizuese për legalizimin e ndërtesave të tyre të banimit, nëse do të jetë e nevojshme¹³. Nga analiza e nevojave për strehim e kryer në kuadër të hartimit të Strategjisë së Strehimit Social është evidentuar se instrumentet aktuale për strehim nuk përmbushin nevojat e grupeve të përjashtuara midis tyre edhe personat me aftësi të kufizuara.

Ligji për programet sociale të strehimit ka identifikuar personat me aftësi të kufizuara si një grup i veçantë me prioritet për programet sociale të strehimit, përkatësisht për subvencionim të qirasë dhe subvencionimet për interesat e kredive. Kjo është specifikuar më tej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 6,8,2014 "Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për përfitimin e grantit të menjëhershëm" nëpërmjet të cilit personat me dëmtim të plotë ose të pjesshëm të shikimit që e kanë të pamundur të punojnë në kushte normale pune, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve të pajisur me vërtetim nga komisioni mjekësor (KMCAP), personave me aftësi të kufizuara të paaftë për punë dhe që kanë një vërtetim nga KMCAP-ja dhe personat e deklaruar si invalidë pune¹⁴, përfitojnë falas në masën deri 10 % të vlerës së banesës me kosto të ulët të përfituar. Bazuar në kërkesat e bashkisë, Ministria e Zhvillimit Urban çdo vit alokon fonde për grantin e menjëhershëm për përfituesit e banesave me kosto të ulët. Familjet që përfitojnë nga granti i menjëhershëm janë ato që kanë si anëtar një person me aftësi të kufizuara, në mënyrë të veçantë, persona me dëmtim të plotë ose të pjesshëm të shikimit që e kanë të pamundur të punojnë në kushte normale pune, paraplegjikë dhe tetraplegjikë të pajisur me vërtetim nga KMCAP, persona me aftësi të kufizuara të paaftë për punë dhe që kanë një vërtetim nga KMCAP-ja, persona të deklaruar si invalidë pune, dhe persona me çrregullime të shëndetit mendor të cilët kanë nevojë për përkujdesje. VKM e sipërcituar përcakton gjithashtu se bazuar në kërkesat e bashkive, Ministria e Zhvillimit Urban planifikon dhe alokon fonde për grantin e menjëhershëm për përfituesit e banesave me kosto të ulët. Po ashtu, nuk ka komplekse ose njësi banimi ku personat me aftësi të kufizuara mund të jetojnë në mënyrë të pavarur me shërbime të personalizuar mbështetëse.

Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e përfituesve, pasi janë bashkë ato të cilat bëjnë perzgjedhjen dhe administrimin e kërkesave për strehim e midis tyre edhe të granteve të menjëhershme. Gjithsesi kërkesat për grante kanë qenë të vogla. Enti Kombëtar i Banesave është përgjegjës për përmirësimin e aksesueshmërisë dhe instalimin e pajisjeve mbështetëse për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara në strehimin social. Këto

12 Ligji nr. 9232.

13 VKM nr. 488, datë 22 korrik 2014, "Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës".

14 VKM nr. 526 "Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara të cilët trajtohen me përparësi si përfitues të programeve sociale të strehimit".

aspekte janë përfshirë edhe në projektin e banesave sociale me qira të ndërtuara në tetë bashki me kredi të bankës CEB.

Edhe në sektorin privat standardet e aksesueshmërisë zbatohen shumë rrallë. Shumica e objekteve turistike private nuk janë të aksesueshme dhe ky aspekt nuk trajtohet nga inspektimet për turizmin. Rrjedhimisht, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përballen me pengesa për të marrë pjesë në veprimtari argëtuese dhe në turizëm. Gjithashtu, kjo nënkupton se personat me aftësi të kufizuara shpesh nuk mund të punësohen në industrinë e turizmit, e cila zë një përqindje të konsiderueshme të ekonomisë në Shqipëri.

Nevojitet një transport i aksesueshëm, i përballueshëm dhe efikas për të bërë të mundur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, për të lehtësuar lirinë e lëvizjes dhe për të nxitur pjesëmarrjen në punësim, arsimim dhe aktivitete të tjera. Legjislacioni ekzistues parashikon ofrimin e transportit me lehtësira për personat me aftësi të kufizuara në zonat urbane dhe rurale, me kosto më të ulëta për biletën¹⁵, si dhe vende të posaçme për ta¹⁶. Megjithatë, në praktikë, pothuaj asnjë mjet transporti publik nuk është i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Respektimi nga shoqëritë e transportit i standardeve të aksesueshmërisë në shërbim është përgjegjësi e organeve të qeverisjes vendore, të cilat edhe kanë përzgjedhur fituesit e kontratave të transportit. Megjithatë, monitorimi nuk është efikas dhe nuk është vendosur asnjë penalitet për moszbatimin e tyre.

Për të lehtësuar aksesin në mjetet e transportit, qeveria ka përjashtuar nga detyrimet doganore automjetet personale të paraplegjikëve ose tetraplegjikëve. Gjithashtu, personat me aftësi të kufizuara mund të modifikojnë automjetet e tyre përpara se të aplikojnë për një leje për drejtimin e automjetit¹⁷. Ata përjashtohen nga tarifat e parkimit dhe taksat e rrugës. Sipas raportit të parë të progresit të qeverisë për zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, personat me aftësi të kufizuara rrallë kanë mundësi t'i përdorin 52 vendet e rezervuara të parkimit në 35 vende të ndryshme¹⁸, por, përpara zyrave të ministrive në Tiranë, nuk mund të gjendet asnjë vend i tillë parkimi. Përveç kësaj, personat që nuk dëgjojnë, nuk lejohen të marrin leje për drejtim automjeti.

Siguria në rrugë është e rëndësishme për të parandaluar aksidentet që shkaktojnë aftësi të kufizuara. Suksesi në këtë fushë ka qenë i përzier, pavarësisht fushatave të ndërgjegjësimit (shih figurën 1).


15 Megjithatë, disa ofruer të transportit refuzojnë të ofrojnë një ulje çmimi të tillë, sepse ata nuk rimburohen nga Ministria e Financave apo nga qeverisja vendore.

16 Ligji për transportin rrugor, neni 85.

17 Modifikimet duhet të miratohen nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

18 Faqja 25.

Figura 1: Numri i aksidenteve serioze rrugore



Nuk dihet sesa prej këtyre aksidenteve kanë shkaktuar aftësi të kufizuara të përkohshme ose të përhershme, por është e qartë se përpjekjet e vazhdueshme do të çonin në siguri më të madhe në rrugë dhe do të ulnin numrin e personave të tjerë me aftësi të kufizuar.

1.1.2 Aksesit në informacion

Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara parashikon garantimin e jetesës së pavarur nëpërmjet politikave të komunikimit dhe informacionit dhe formateve të aksesueshme. Këtu përfshihen shtypja dhe botimi në alfabetin Braille, shtypja me shkronja të mëdha, përdorimi i një gjuhe të thjeshtuar dhe formate elektronike të aksesueshme nga programet e leximit. Megjithatë, për shembull, tekstet shkollore të shkollave të përgjithshme nuk ekzistojnë në alfabetin Braille apo në formate audio. Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë nuk mund të plotësojë kërkesat për tekste shkollore në alfabetin Braille për shkak të fondeve të kufizuara dhe kapacitetit teknik të kufizuar.

Po ashtu, faqet qeveritare të internetit dhe portalet nuk janë të aksesueshme për programet e leximit për personat që kanë nevojë për shkrim të madh apo kontrast si dhe në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë. Në standartet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për faqet e internetit të institucioneve të qeverisë, duhet të merren parasysh elementët e aksesueshmërisë.

Aksesueshmëria në programet informative dhe në median e përgjithshme do t'u mundësonte personave me aftësi të kufizuara të informoheshin dhe të merrnin pjesë në jetën politike dhe publike. Për momentin, programet televizive në gjuhën e shenjave janë të kufizuara vetëm në televizionin kombëtar (TVSH) që transmeton një program informativ prej 10 minutash në ditë. Gjithashtu personat që nuk dëgjojnë nuk kanë akses në informacion për arsye të mungesës së titrave në programe dhe edicione lajmesh në televizione të ndryshme.

Për të përmirësuar aksesin në informacion dhe njohjen e të drejtave të tyre, qeveria ngriti në vitin 2013 një grup pune ndërinstitucional për ta bërë zyrtare gjuhën e shenjave në Republikën e Shqipërisë. Një vit më vonë, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim “Për njohjen e gjuhës shqipe të shenjave” me qëllim nxitjen e përdorimit të saj në shërbimet publike dhe aksesin në informacion. Megjithatë, personat që nuk dëgjojnë pothuajse nuk kanë akses nëpërmjet gjuhës së shenjave në shërbimet private apo publike.

1.2 Barazia

Në vitin 2014, ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” përcaktoi parimet dhe shërbimet në fushën e barazisë dhe aksesit në drejtësi. Ai garanton promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me qëllim mundësimin e përfshirjes së tyre të plotë dhe efikase në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me pjesën tjetër të shoqërisë, duke mundësuar në të njëjtën kohë autonomi dhe jetesë të pavarur me anë të ndihmës dhe përkujdesjes. Po kështu, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i miratuar në vitin 2010, parashikon respektimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit që, mes të tjerash, lidhen me aftësitë e kufizuara¹⁹. Këto ligje janë në përputhje me Konventën e OKB-së dhe duhet të integrohen në ligje dhe akte nënligjoret tjera.

Një anketim i kryer në vitin 2010 nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Civil Rights Defenders zbuloi se në 94% të rasteve, personat me aftësi të kufizuara përfaqësoheshin në gjykatë nga përfaqësuesit e tyre, zakonisht anëtarë të familjes, të cilët janë të painformuar për procedurat ligjore²⁰. Kur personat me aftësi të kufizuara paraqiteshin personalisht në gjykatë, shpesh është dashur që dikush t’i ngrejë ata nga njëri kat në tjetrin ose në disa raste gjyqtari detyrohej të shkonte në shtëpinë e personit me aftësi të kufizuara. Nga 23 gjykata të anketuara, vetëm 8 kishin rampa në hyrje të tyre dhe 6 prej tyre kishin ashensorë. Nga 5 gjykatat që kishin faqe interneti, asnjë nga ato nuk ofronte funksione aksesit. Shumica e gjykatave (83%) nuk mund të sigurojnë informacion të aksesueshëm për persona me probleme në shikim, dëgjim dhe zhvillim²¹.

Këto pengesa prekin edhe **lirinë për të bërë zgjedhje individuale**. Për shkak të inekzistencës së një sistemi operativ për të mbështetur vendimmarrjen²², kujdestaria ligjore mbizotëron. Kjo çështje është po aq e rëndësishme si për aksesin në drejtësi, ashtu edhe

19 Ligji nr.10221, datë 4 shkurt 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

20 Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile, *Garantimi i aksesueshmërisë në gjykata dhe shërbimet gjyqësore për personat me aftësi të kufizuara*, 2010, f. 10.

21 *Po aty*.

22 Neni 7 i Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara e përcakton atë si “ushtrim i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara përmes një kompetence specifike të shtuar që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar atij të kryjë veprime për të fituar të drejtave dhe për të marrë përsipër detyrime”. I njëjti nen gjithashtu shpjegon se “Çdo person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje do të marrë mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, duke përfshirë mbështetjen përmes interpretimit në gjuhë shenjave dhe gjuhëtë thjeshtuar, si dhe duke ndihmuar personin me aftësi të kufizuara në marrëdhëniet me të tretët të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë mënyrën e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke i dhënë kohën e mjaftueshme personave që e kërkojnë atë për të mësuar se si të përdorin mbështetjen për interesin e tyre më të mirë.”



për fusha të tjera të Planit të Veprimit. Administrimi i pasurisë nga një kujdestar u mohon personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të menaxhuar pasuritë e tyre financiare dhe të drejtën e posedimit të pasurisë. Sipas nenit 33 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të paraqiten padi ligjore nga një person të cilit i mungon zotësia për të vepruar. Në të njëjtën kohë, në procedurat për të hequr zotësinë e një personi për të vepruar, personi në fjalë nuk ka të drejtë të jetë palë²³.

Kodi Civil përmban dispozita ligjore të cilat bien ndesh me parimin e zotësisë për të vepruar dhe i referohet koncepteve të "prapambetjes mendore", "çrregullimeve të shëndetit mendor" dhe "çrregullimeve psikike", ndërsa Kodi i Familjes parashikon emërimin e një kujdestari në rastet e heqjes/ kufizimit të zotësisë për të vepruar. Kodi i Procedurës Penale parashikon përkthimin për njerëzit që nuk e kuptojnë gjuhën shqipe, por nuk trajton të drejtën për interpretim në gjuhën e shenjave për personat që nuk dëgjojnë.

Deri më sot, aksesimi në sistemin e drejtësisë për të gjithë qytetarët shqiptarë, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, është përmirësuar nëpërmjet **forcimit të kapaciteteve të gjyqësorit dhe të inspektimit**, si dhe krijimit të institucioneve të reja të pavarura, të afta për t'iu përgjigjur shkeljeve. Në raste diskriminimi, personat me aftësi të kufizuara mund të drejtohen te një prej organeve të mëposhtme:

- *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, një institucion shtetëror i pavarur që shqyrton dhe vendos mbi bazën e ankesave individuale në këtë fushë. Komisioneri mund të përfshihet në hetime *ex officio* për çdo trajtim diskriminues të pretenduar dhe të vendosë sanksione për shkeljet.
- *Avokati i Popullit*, një institucion kushtetues i pavarur që mbron të drejtat, lirinë dhe interesat e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standarteve më të larta të të drejtave të njeriut në vend. Kryen inspektime të institucioneve të kujdesit social për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e të drejtave ligjore të përfituesve. Përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtërujes, Avokati i Popullit monitoron respektimin e të drejtave dhe të standardeve në spitalet e shëndetit mendor, burgje dhe në sistemin e paraburgimit. Avokati i Popullit gjithashtu harton rekomandime për institucionet shtetërore. Një nga komisionerët e Avokatit të Popullit është person me aftësi të kufizuara.
- *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*, një organ shtetëror mbikëqyrës i pavarur, përgjegjës për të mbikëqyrur ligjshmërinë e veprimtarive të përpunimit të të dhënave personale.
- *Gjykatat* mund të ofrojnë kompensim për personat që vuajnë nga diskriminimi për shkak të aftësive të kufizuara²⁴, përfshirë edhe mohimin e një përshtatjeje të arsyeshme.

²³ Prezenca e OSBE në Shqipëri, *Drejt Drejtësisë: Analiza e procedurave civile në gjykatat e rretheve*, <http://www.osce.org/albania/100388>, f. 13.

²⁴ Ligji nr.10221, datë 4 shkurt 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 33.

- *Drejtoria e Monitorimit të Standardeve të Shërbimit Social Shtetëror* monitoron gjithashtu standardet e shërbimit.

Oficerët e policisë trajnohen rregullisht në lidhje me trajtimin e të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara (këto module janë përfshirë në kurrikulën e shkollës së policisë). Gjithashtu, janë ofruar disa trajnime në Shkollën e Magjistraturës për gjykatësit dhe prokurorët. Trajnimi u përqendrua në dispozitat e Konventës së OKB-së, por duhet më shumë punë në këtë fushë për të mundësuar zbatimin efikas të së drejtës për barazi përpara ligjit. Është bërë vetëm një trajnim bazë dhe numri i gjykatësve dhe prokurorëve që morën pjesë ishte i kufizuar.

Deri në maj 2015, në të gjithë vendin gjenden në burg²⁵ 363 meshkuj dhe 16 femra me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ligji parashikon se personat me aftësi të kufizuara “mund të qëndrojnë në shtëpitë e tyre me urdhër heqje lirie me kusht ose në një tjetër objekt të përshtatshëm të siguruar nga policia”²⁶. Në **sistemet e (para)burgimit** personat me aftësi të kufizuara mbahen në njësi të veçanta ose institucione të veçanta. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka ngritur shqetësime në lidhje me kushtet e personave me aftësi të kufizuara në këto institucione²⁷. Për rastin e burgut të Zaharisë në Krujë, Gjykata “ka nxitur autoritetet shqiptare që të jepnin [...] informacion të detajuar për regjimin juridik dhe praktikën që rregullon disponueshmërinë e trajtimit mjekësor për të ndaluarit”²⁸.

Ndihma juridike nuk përfitohet falas nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara, por vetëm nga ata që janë viktimë të dhunës në familje apo të trafikimit të qenieve njerëzore (dhe vetëm për procedura gjyqësore të ngjashme), nga ata që përfitojnë (ose që kualifikohen për) ndihmë sociale dhe të miturit që kërkojnë mbrojtje në një proces dhe gjykim penal. Aksesi mendohet të përmirësohet nëpërmjet ngritjes së zyrave rajonale, por shtrirja e shërbimeve mbetet e kufizuar për shkak të kufizimeve në fonde publike, mungesës së aksesueshmërisë në disa ndërtesa dhe mungesës së materialeve dhe informacionit të ndihmës juridike në alfabetin Braille dhe/apo formate alternative të aksesueshme. Deri në shtator 2015, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike nuk ka ofruar shërbime për ndonjë person me aftësi të kufizuara²⁹.

Gratë me aftësi të kufizuara përfaqësonin 2% të rasteve të raportuara **të dhunës në familje** në vitin 2014 dhe vetëm 1% në vitin 2013. Megjithatë, Këshilli i Evropës paralajmëron se “shkalla e dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara është dukshëm më e lartë në krahasim me popullsinë e përgjithshme, dhe akoma më e lartë te gratë me aftësi të kufizuara, veçanërisht te gratë me aftësi të kufizuara të rënda, tek të cilat përqindja

25 Raporti i parë i progresit i qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2015, f. 30.

26 Neni 255 i Kodit të Procedurës Penale.

27 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vendimet në çështjen Dybeku kundër Shqipërisë 41153/06 në 2007 dhe 557/12 në 2014; si dhe vendimet e marra në takimin e 1164-t të zëvendësministrave, 5-7 mars 2013.

28 Vendimi 5 i marrë në lidhje me çështjen Dybeku kundër Shqipërisë në takimin e 1164-t të zëvendësministrave, 5-7 mars 2013.

29 Qeveria e Shqipërisë, *Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale, 2015-2020*, f. 128.



e abuzimit e tejkalon së tepërmi atë të grave pa aftësi të kufizuara³⁰. Disa raste nuk raportohen për shkak të stigmës së dhunës në familje, mungesës së njohurive për burimet në dispozicion dhe mbrojtjes së kufizuar, si dhe të opsioneve të akomodimit për të gjitha viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, gratë me aftësi të kufizuara mund të hezitojnë t'i raportojnë abuzimet nëse janë të varura nga abuzuesi i cili e ka në kujdestari.

Duke njohur rëndësinë e kësaj çështjeje, qeveria miratoi ligjin "Për masat kundër dhunës në familje" në vitin 2006, duke garantuar mbrojtje me masa ligjore dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje funksionon që nga viti 2011 (e aksesueshme për persona me aftësi të kufizuara) dhe, në vitin 2014, qeveria krijoi një sistem online për regjistrimin e rasteve të reja.

1.3 Punësimi dhe AFP-ja

Ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara garanton të drejtën për jetesë të pavarur, duke përfshirë edhe aksesin në punësim. Kodi i Punës ndalon çdo formë diskriminimi në fushën e punësimit dhe profesionit, ndërsa draft ndryshimet e tij të fundit i harmonizojnë përkufizimet me ligjin kundër diskriminimit dhe përcaktojnë kufizime për çdo trajtim të ndryshëm, kufizim, përjashtim ose preferencë. Ligji për arsimin dhe formimin profesional, mes përfituesve specifikon edhe "grupe të veçanta" (terminologji që përfshin edhe personat me aftësi të kufizuara).

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi siguron të drejtën e ankimit për çdo viktimitë diskriminimi me bazë aftësinë e kufizuar apo arsye të tjera, dhe gjithashtu fut edhe konceptin e "**përshtatjes së arsyeshme**". Edhe Kodi i Punës i ndryshuar dhe miratuar së fundmi specifikon se punëdhënësi është i detyruar të garantojë përshtatje të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara në vendin e punës. Kjo përfshin modifikime dhe ndryshime të nevojshme të vendit të punës dhe që nuk të ngarkojnë me barrë të tepërt. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim dhe në çdo rast gjyqësor barrën e provës e ka punëdhënësi³¹.

Ligji për nxitjen e punësimit parashikon **kuota punësimi** për personat me aftësi të kufizuara për punëdhënësit e sektorit privat dhe publik. Çdo kompani apo institucion publik me më shumë se 24 punonjës, duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës. Megjithatë, penalitetet në fuqi për punëdhënësit që nuk përmbushin këto kuota nuk zbatohen. Vërehet se edhe në institucionet shtetërore numri i të punësuarëve me aftësi të kufizuar është i vogël.

30 Këshilli i Evropës, *Plani i Veprimit për nxitjen e të drejtave dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri: Përmirësimi i Cilësisë së Jetës për Personat me Aftësi të Kufizuara në Evropë, 2006-2015*, linja e veprimit nr. 13: Mbrojtja kundër dhunës dhe abuzimit, f. 27, e disponueshme në adresën: http://www.coe.int/t/e/social_cohesion/soc-sp/Rec_2006_5DisabilityActionPlan.pdf.

31 Ligji nr. 10221, datë 4 shkurt 2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 36, pika 6: "Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji".

Nëngrupe të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara si të verbërit, invalidët e punës, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, kanë përfitime të veçanta të përcaktuara me ligj, duke çuar kështu në diskriminimin e kategorive të tjera të aftësisë së kufizuar. Sipas Ligjit nr. 8626, datë 22 qershor 2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i rishikuar, punëdhënësit që marrin në punë paraplegjikët dhe tetraplegjikët gëzojnë të drejtën e uljes së taksave³², por në praktikë kjo nuk ndodh. Numri i të punësuarve që bëjnë pjesë në këto grupe mbetet ende i ulët.

Në nivelin e akteve nënligjore, në vitin 2003, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim "Për programin e **nxitjes së punësimit** të punëkërkueseve të papuna femra", i pasuar nga vendimi "Për programet e nxitjes së punësimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara" në vitin 2014. Programi u zbatua si program pilot në Tiranë dhe Elbasan me 14 përfitues në vitin 2014 dhe më pas u prezantua në të gjithë vendin në vitin 2015, ku deri në shtator kishte 31 përfitues. Ky kuadër parandalon diskriminimin dhe ofron stimuj për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara:

- Punëdhënësi që punëson një PAK përfiton një financim për të pajisur siç duhet vendin e punës/transport (përshtatja e arsyeshme) të personit me aftësi të kufizuar dhe për t'i siguruar atij/asaj një përgatitje thelbësore për punën, deri në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë, nëse punëson më shumë se dy persona. Për këtë, punëdhënësit duhet të paraqesin një projekt për përshtatjen e arsyeshme; Siç është shpjeguar në kapitullin e kujdesit social, personat me aftësi të kufizuara nuk i humbasin përfitimet e tyre për aftësinë e kufizuar gjatë 24 muajve të parë të punësimit.
- Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore kontribuon për sigurimin shëndetësor në rast aksidenti në punë (duke mbuluar 0,3% të pagës mesatare minimale)³³.
- Punëdhënësi që punëson një PAK përfiton një financim mujor në masën deri në 100 për qind të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të pjesës së kontributit të punëdhënësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në degën përkatëse të tatimeve, sipas procedurave përkatëse;
- Shteti paguan pjesën e sigurimit të detyrueshëm të punëdhënësit për çdo femër me aftësi të kufizuara të punësuar. Pagesa financiare rritet deri në katër paga minimale mujore për kontratat vjetore të punës, gjashtë paga për kontratat dyvjeçare dhe tetë paga për kontratat trevjeçare.

Numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë tre viteve të fundit. Në vitin 2012 u punësuan vetëm 13 persona me aftësi të kufizuara, në vitin 2013 ky numër arriti në 79 dhe në vitin 2014 në 127.

32 Ligji nr. 8626, datë 22 qershor 2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i rishikuar.

33 Këto kontribute mblihdhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe zakonisht burojnë nga fondet e akorduara për programet e nxitjes së punësimit.



Ekzistojnë edhe dispozita të tjera, por ato nuk mund të zbatohen për shkak të pengesave praktike ose rregullatore që duhet të trajtohen:

- Pagat e personave me aftësi të kufizuara përjashtohen nga tatimi deri në një nivel të caktuar, por ky nivel mbetet ende për t'u përcaktuar në një VKM dhe ndërkohë përfitimet nuk mund të përdoren.
- Të verbrit, tetraplegjikët dhe paraplegjikët që janë të vetëpunësuar përfitojnë nga ulja e taksave, por kjo dispozitë në praktikë nuk funksionon.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) ka bashkëpunuar me organizata të shoqërisë civile për të rritur shtrirjen e shërbimeve të personat me aftësi të kufizuara. Disa prej zyrave të SHKP-së janë pjesërisht të aksesueshme, ndërsa të tjera kanë probleme pronësie dhe ndërtesa nuk mund të modifikohet. Në SHKP është punësuar vetëm një person me aftësi të kufizuara dhe numri i personave me aftësi të kufizuara të regjistruar si të papunë mbetet relativisht i ulët. Ky numër ishte 1275 në gusht 2015 krahasuar me 1732 të tillë të regjistruar një vit më parë. Personat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa për të hyrë në tregun e punës për shkak të nivelit mesatar të ulët të arsimit dhe kualifikimit profesional, si edhe diskriminimit nga punëdhënësit. Në përgjigje të këtyre çështjeve, në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe Planinë e saj të Veprimit është modeluar një kuadër ri për nxitjen e punësimit, i cili përqendrohet tek modernizimi i mënyrës së shërbimit nga punonjësit e zyrave të punësimit, si në nivel qarku, ashtu edhe lokal me modelin e ri të shërbimeve me tre nivele, i bazuar tek teknikat e profilizimit, kryesisht për personat me nevojat të vecanta. Janë hapur 14 zyra të reja punësimi në rajonet kryesore të vendit, në të cilat ofrohet modeli i ri i shërbimeve të punësimit, me standarte evropiane.

Programet e Arsimit dhe Formimit Profesional përbëjnë një nga mënyrat për të përmirësuar kualifikimet dhe aftësitë e një personi. Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë falas kurset e formimit profesional, por ndërtesat e qendrave të AFP-së janë kryesisht të paaksesueshme³⁴. Gjithashtu, qendrat nuk kanë udhëzime për t'i përshtatur kurrikulat sipas nevojave të pjesëmarrësve me aftësi të kufizuara, stafi i tyre nuk është trajnuar në këtë fushë dhe ata nuk kanë punësuar asnjë person me aftësi të kufizuara. Në vitin 2015, 134 persona me aftësi të kufizuara kanë përfunduar kurset e formimit profesional falas.

³⁴ Nga 10 qendra të AFP-së (2 në Tiranë, 7 në rrethe dhe 1 e lëvizshme për rajonet verilindore) vetëm tre janë pjesërisht të aksesueshme, ato që ndodhen në ish-fabrika ku kati përdhës është i aksesueshëm, por jo banjat dhe katet e sipërme. Aktualisht po punohet në dy qendra: QFP Tiranë dhe QFP Vlorë për të bërë plotësisht të aksesueshme.

1.4 Arsimimi

E drejta për arsim për të gjithë fëmijët në Shqipëri, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, është e garantuar nga një shumëllojshmëri ligjesh dhe rregulloresh, si dhe nga objektivat sociale të përcaktuara në kushtetutë. Ligji për arsimin parauniversitar përcakton parime që udhëzojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, konkretisht për zhvillimin e potencialit të tyre fizik dhe intelektual, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e integritetit të tyre të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës. Ligji promovon konceptin e arsimit gjithëpërfshirës, duke theksuar se përfshirja në institucione arsimore të specializuara është e përkohshme dhe se përfshirja në kopshte dhe shkolla të përgjithshme ka rëndësi primare. Në të njëjtën kohë, të dhënat e censusit tregojnë se vetëm 55,6% e personave me aftësi të kufizuara mbi 15 vjeç kanë përfunduar arsimin bazë. Vetëm 3,3% e personave me aftësi të kufizuara kanë përfunduar studimet (pas)universitare. Pothuajse një e katërta (24,3%) e personave me aftësi të kufizuara nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit regjistron dhe monitoron fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor. Në harmoni me nismën “Çdo fëmijë në shkollë” duhet përforcuar bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka pasur një rritje prej 33% të numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e zakonshëm (shih tabelën 1).

Tabela 1: Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivele të ndryshme të arsimit

Të dhënat	Viti akademik 2013-2014 ³⁵	Viti akademik 2014-2015 ³⁶
<ul style="list-style-type: none"> Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në kopshte dhe arsim fillor 	1652 fëmijë, përfshirë 302 në ciklin parashkollor dhe 1350 në ciklin e ulët	1947 fëmijë, përfshirë 421 në ciklin parashkollor dhe 1526 në ciklin e ulët
<ul style="list-style-type: none"> Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e lartë 	758 nxënës (570 në arsimin e mesëm të ulët dhe 188 në arsimin e mesëm të lartë)	1254 nxënës (915 në arsimin e mesëm të ulët dhe 339 në arsimin e mesëm të lartë)
<ul style="list-style-type: none"> Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat speciale 	702 (222 vajza dhe 480 djem)	700

Ministria e Arsimit dhe Sporteve, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, prindërit dhe Drejtoritë/Zyrat Arsimore përpiqen të sigurojnë që çdo fëmijë të regjistrohet në një shkollë të përgjithshme apo speciale. Teorikisht ekziston edhe varianti i arsimimit në

³⁵ UNICEF, Analiza për situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara, 2014.

³⁶ Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, *Rishikimi i raporteve të dorëzuar nga shtetet palë bazuar në nenin 35 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, draft raporti i parë, 2015, f. 41.*



shtëpi për fëmijët që nuk mund të shkojnë në shkollë, e përcaktuar për herë të parë në një udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Megjithatë, nuk ka pasur udhëzime të mëtejshme deri më sot që do të mund të bënin funksionale këtë mundësi për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Qeveria është e angazhuar të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, por ende duhet të ngrihen disa themele të rëndësishme për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Këtu përfshihet:

- Përdorimi i mësuesve ndihmës në arsimin bazë përcaktohet në një udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve të vitit 2014³⁷. Mësuesit me një kuotë të pamjaftueshme orësh u pyetën nëse dëshironin të punonin si asistentë mësues për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vetëm 65 prej tyre aplikuan, ndërkohë që nevojat ishin shumë më të mëdha (3200 fëmijë). Shkollat speciale po përdoren si qendra trajnimit për asistentët mësues, por mësuesit që punojnë në shkollat speciale nuk mund të marrin rolin e një asistenti duke qenë se ata janë të mbikualifikuar.
- Me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve është miratuar “Profili i mësuesit gjithëpërfshirës” që do të shërbejë si udhëzues për formim dhe zhvillim profesional të mësuesit gjithëpërfshirës.
- Librat shkollorë për arsimin e zakonshëm nuk janë të disponueshme në formate të aksesueshme (p.sh. në braille ose format dixhital).
- Çdo drejtori arsimorë duhet të ketë (por ende nuk ka) komisione multidisiplinore përgjegjëse për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Sipas modelit bio-psiko-social, komisionet përcaktojnë nevojën e fëmijës për mësues ndihmës dhe japin udhëzime për hartimin e planit individual të mësimin për të. Planet individuale të mësimin nuk po përdoren ende.
- Infrastruktura dhe ambientet fizike në shkollë në përgjithësi nuk janë të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas një studimi të kohëve të fundit, vetëm 35% e kopshteve dhe e shkollave 9-vjeçare plotësojnë kushtet për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara³⁸. Planet e rinovimit dhe rikonstruksionit të objekteve shkollore miratohen nga njësitë e qeverisjes vendore.
- Rinovimet e shkollave janë përgjegjësi e qeverisjes vendore, por ministria kontrollon planet e rinovimit dhe është e angazhuar për zbatimin e të gjithë standardeve të aksesueshmërisë. Në vitin 2015, aksesueshmëria u përfshi për herë të parë edhe në kriteret për shkollat private.
- Është në proces miratimi profili i mësuesit gjithëpërfshirës, që do të shërbejë si udhëzues për formim dhe zhvillim profesional të mësuesit gjithëpërfshirës.

³⁷ Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve nr. 38, datë 7 tetor 2014, “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

³⁸ Studim Analitik *Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri*, Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me “Save the Children” dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.

- Programi mësimor për edukimin e mësuesve të përgjithshëm nuk ka përmbajtje të mjaftueshme për mësimdhënien për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mësuesit e shkollave të përgjithshme e kanë të vështirë që pa mësuesit ndihmës të plotësojnë nevojat e të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë dhe disa prindër hezitojnë të regjistrojnë fëmijët në shkolla të përgjithshme.
- Njëkohësisht, Shoqata Shqiptare e Personave që nuk Dëgjojnë ANAD ka ndërmarrë një studim për të parë mundësinë e shtrirjes së arsimit të fëmijëve që nuk dëgjojnë deri në nivelin e arsimit të mesëm.
- Këto pengesa pengojnë seriozisht arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe duhet të trajtohen në mënyrë sistematike në të ardhmen.

Përveç kësaj, të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara përballen me sfida për të pasur akses në nivelet e arsimit të lartë. Ka kuota të rezervuara për grupe të ndryshme të synuara, por këto kuota nuk plotësohen çdo vit (tabela 2).

Tabela 2: Përdorimi i kuotave për nxitjen e aksesit në arsimin e lartë

Niveli Bachelor		Niveli Master	
Kuotat	Regjistrimi aktual (2014-2015)	Kuotat	Regjistrimi aktual (2014-2015)
15 kuota të rezervuara për persona me probleme shikimi 15 për paraplegjikët dhe tetraplegjikët 20 për romët dhe egjiptianët 15 për jetimët	42 për studentët me aftësi të kufizuara (23 meshkuj dhe 19 femra) në lëndë si drejtësi, histori, psikologji, punë sociale, menaxhim, kontabilitet dhe financë, menaxhim biznesi, arkitekturë dhe IT	15 kuota për persona me probleme shikimi 15 për paraplegjikët dhe tetraplegjikët 15 për romët dhe egjiptianët 15 për jetimët	12 studentë (gjashtë meshkuj dhe gjashtë femra), duke përfshirë vetëm dy studentë me aftësi të kufizuara
65 vende në total	42 studentë të regjistruar në total	60 vende në total	12 studentë të regjistruar në total

Siç tregohet, në nivelin parauniversitar janë zënë vetëm rreth 75% e vendeve dhe akoma më pak në nivelin universitar. Arsyet përfshijnë mungesën e aksesueshmërisë në ndërtesat e universiteteve, mungesën e asistencës për studentët me aftësi të kufizuara dhe profesorëve të tyre në klasë, si dhe mungesën e librave në formate të ndryshme. Disa nxënës me aftësi të kufizuara (për shembull, persona që nuk dëgjojnë), për arsye të vështirësive në leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe dhe mungesës së aksesit nëpërmjet interpretit të gjuhës së shenjave, nuk mund të kryejnë arsimin e mesëm në Shqipëri, si rrjedhim nuk mund të ndjekin universitetin.



1.5 Kujdesi social

Numri i përfituesve³⁹ që kanë përdorur sistemin e mbrojtjes sociale për shkak të aftësisë së kufizuar ishte 162 350 në vitin 2014 dhe 157 434 në vitin 2015. Invalidët e punës përfaqësojnë nëngrupin më të madh (74 373 persona). Familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara janë të varur nga **pagesat e aftësisë së kufizuar**: 79% e tyre marrin një formë transferte të mbrojtjes sociale, pothuajse sa dyfishi i familjeve që nuk kanë ndonjë anëtar me aftësi të kufizuara⁴⁰. Transfera e mbrojtjes sociale përfshijne: pagesën e paaftësisë, ndihmen ekonomike si dhe lehtësimet në pagesat e energjisë. Përveç kësaj, janë edhe 8 254 familje që marrin ndihmë ekonomike dhe që kanë një anëtar me aftësi të kufizuara, por kjo nuk ka qenë arsyeja bazë për dhënien e kësaj ndihme. Duhet të theksohet se "edhe pse pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur nga viti në vit, është ende e qartë se njerëzit me aftësi të kufizuara e kanë të vështirë të mbulojnë shpenzimet e tyre"⁴¹.

Përfitime shtesë janë përcaktuar për grupe të veçanta personash me aftësi të kufizuara nëpërmjet legjisllacionit të specializuar (shpesh referuar si ligje-statuse)⁴². Për ta përmbledhur, këto ligje parashikojnë:

- Pagesë për Aftësinë e Kufizuar⁴³ (nga 10,030 lekë deri në 11,390 lekë në muaj, si dhe shuma të ngjashme për kujdestarët e tyre),
- Kompensim financiar për disa fatura mujore të shërbimeve utilitare,
- Ndihmë financiare shtesë për personat me aftësi të kufizuara që ndjekin studimet (vetëm të verbrit, paraplegjikët, tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike),
- Akses me përparësi në programet e strehimit dhe nxitjes së punësimit (*po aty*),
- Rimbursimi i barnave dhe sigurimi shëndetësor falas,
- Ndihmë financiare të veçantë për personat me aftësi të kufizuara të cilët humbën vendin e tyre të punës pas vitit 1991 (vetëm të verbrit),
- Karrige me rrota, paterica, paketa higjieniko-sanitare falas (vetëm për paraplegjikët dhe tetraplegjikët), edhe pse karriget me rrota apo mjetet e tjera ndihmëse deri tani janë ofruar në disa raste nga donatorë të ndryshëm.
- Përjashtimin nga taksat direkte (*po aty*),
- Përjashtime tatimore dhe doganore për pajisje rehabilitimi dhe automjetet (vetëm për paraplegjikët, tetraplegjikët dhe invalidët e punës); rimbursim të karburantit në vlerën 7000 lekë/muaj (vetëm invalidët e punës).

39 Personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.

40 Anketimi i AMNJ-së, 2012.

41 Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, Raporti i Vlerësimit - Strategjia Kombëtare Ndërsektorale për Përfshirjen Sociale në Shqipëri, 2007-2013, botuar në vitin 2012, f. 59.

42 Ligji "Për statusin e të verbrit", ligji "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe ligji "Për statusin e invalidit të punës".

43 Ndihma financiare mujore indekskohet çdo vit në bazë të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK).

Personat me aftësi të kufizuara si pasojë e një aksidenti në punë, sëmundjeve profesionale dhe personat me pension të plotë invaliditeti nga një sëmundje gjenetike gjithashtu përfitojnë ndihmë financiare shtesë, në varësi të shkallës së aftësisë së kufizuar.

Çdo ndihmë financiare e lartpërmendur jepet edhe 24 muaj të tjerë pasi përfituesi gjen punë, Përfitimet e marra nga personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike gjithashtu nuk përfshihen në llogaritjen e të ardhurave të familjes kur bëhet vlerësimi i të drejtës për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike. Megjithatë, personat që marrin një pagesë për aftësinë e kufizuar nuk përfshihen në numrin e anëtarëve të familjes për llogaritjen e përfitimeve nga ndihma ekonomike.

Personat me aftësi të kufizuara kur kualifikohen si të tillë nga vlerësimi i kryer nga KMCAP përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar. Kjo pagesë nuk bazohet në vlerësimin e nevpjave të personit me aftësi të kufizuara dhe nuk cilëson çfarë supozohet të mbulojë.

Kur shikojmë tendencat e mbulimit, mund të vihet re se numri i personave me aftësi të kufizuara që marrin pagesa është rritur me 28% nga viti 2009 deri në vitin 2013, ndërsa buxheti i shtetit në total është rritur 62% për të njëjtën periudhë (tabela 4).

Tabela 4:⁴⁴ Numri i përfituesve me aftësi të kufizuara dhe buxheti i shtetit për pagesat e aftësisë së kufizuar 2009 dhe 2014

Përfituesit me aftësi të kufizuara	2009	2014	Ndryshimi në %
Numri total	127,473	164,015	28%
Persona të verbër	11,129	12,330	11%
Paraplegjikë dhe tetraplegjikë	4,560	6,472	42%
Aftësi të kufizuara mendore dhe fizike	44,230	55,416	25%
Invalidë Pune	52,277	74,114	41%
Kujdestarë	15,193	15,683	3 %
Buxheti i shtetit (Lek)	2009	2013	Ndryshimi në %
Buxheti total	10,273,000	16,682,000	62%

Me synim mirëmenaxhimin e fondeve të destinuara për sistemin e mirëqenies sociale dhe për të rritur efikasitetin e përdorimit të tyre, qeveria ka nisur **një reformë të përgjithshme të shërbimeve të mbrojtjes sociale**. Zonat pilot në Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ku po pilotohet sistemi i ri i përfitimit të NE, kërkojnë një dokumentacion më të thjeshtë, kanë një regjistër elektronik në kohë reale që përdoret nga administratori social, nga sekretaria e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore dhe nga Shërbimi Social Shtetëror, ofrojnë


44 Burimi i informacionit SHSSH

informacion të verifikuar ndërmjet njësive të ndryshme të qeverisjes dhe kërkojnë takime me administratorin social çdo tre muaj (në vend të takimeve mujore).

Përveç pagesës së aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të përfitojnë edhe nga **shërbimet e kujdesit social**. Ekzistojnë 28 ofrues shërbimi, ku përfshihen 12 qendra rezidenciale (gjashtë publike dhe gjashtë jopublike), 14 qendra të kujdesit ditor (shtatë publike dhe shtatë jopublike) dhe dy qendra komunitare jopublike⁴⁵. Qendrat rezidenciale (referuar edhe si qendra të zhvillimit) ekzistojnë në Tiranë, Durrës, Shkodër, Berat, Vlorë, Korçë dhe Poliçan⁴⁶. Ata ofrojnë rehabilitim, vetëshërbim dhe arsimim për integrimin e personave me aftësi të kufizuara nën 25 vjeç, në jetën e komunitetit. Nevojitet një model i ri, veçanërisht për të rritur (+25 vjeç) me AK, në mënyrë që këto qendra të mund të promovojnë jetesën e pavarur nëpërmjet aftësimin për jetën dhe aftësimin për punësim.

Gjatë vitit 2015, 1437 të rritur dhe fëmijë përdorin qendrat rezidenciale dhe të kujdesit ditor (ndarja e përfituesve tregohet në tabelën 5 më poshtë). Pjesa më e madhe e përfituesve përdorin shërbimet e kujdesit ditor (1050 persona, në krahasim me 387 persona që përdorin kujdesin rezidencial, shih figurën 3). Megjithatë, mbulimi gjeografik dhe numri i këtyre qendrave është i pamjaftueshëm.

Figura 3: Përfituesit e qendrave të kujdesit rezidencial dhe ditor



⁴⁵ Të gjitha statistikat për shërbimet e kujdesit social mundësohen nga raporti i parë i progresit i qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, maj 2015, f. 51.

⁴⁶ Qendra polivalente në Poliçan administrohet nga Shërbimi Social Shtetëror, ndërsa të tjerat janë përgjegjësi e organeve të qeverisjes vendore. Për momentin, qendra në Poliçan nuk strehon persona me aftësi të kufizuara, por të moshuar.

Tabela 5: Numri i përfituesve në qendrat publike dhe jopublike rezidenciale dhe të kujdesit ditor (maj 2015)

	Qendra publike rezidenciale dhe të kujdesit ditor	Qendra jopublike rezidenciale dhe të kujdesit ditor	Totali i përfituesve në qendrat publike dhe jopublike
Përfitues	461	976	1,437
Nga të cilët: fëmijë	218	209	427

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë për Familjet Kujdestare, gjatë periudhës 2012-2015, 190-195 fëmijë që më parë ishin rezidentë nëpër institucione, janë vendosur në familje kujdestare⁴⁷. Nga keta vetem 18 femije jane me aftesi te kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara vendosen në qendra rezidenciale atëherë kur jetesa në mënyrë të pavarur bëhet e pamundur, kur anëtarët e familjes nuk janë të gatshëm apo të aftë për t'u kujdesur për përfituesit, në rast braktisjeje apo të kushteve të papërshtatshme të jetesës (p.sh. mungesa e përshtatjes së arsyeshme). Nisma për vendosjen e individit me aftësi të kufizuara në këto qendra vjen nga prindi apo personi kujdestar i caktuar nga gjykata, KMCAP-ja, strukturat e policisë së shtetit, administratori social në njësinë e qeverisjes vendore dhe njësia e ndihmës dhe e kujdesit social në nivelin e qeverisjes vendore. Pranimi përcaktohet nga Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror kryetar i së cilës është Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror.

Qendrat e zhvillimit kanë rregulla të brendshme që synojnë të parandalojnë dhe të trajtojnë rastet e keqtrajtimit. Të gjitha institucionet regjistrojnë të dhëna për rastet e dhunës, por deri tani nuk ka pasur asnjë rast të përdorimit të mjeteve të kufizimit. Numri i personave me aftësi të kufizuara për një qendër është relativisht i ulët (afërsisht 40), por shpeshherë i lartë në krahasim me kapacitetin dhe stafin e qendrës. Sipas ligjit, vetëm personat nën moshën 25 vjeç mund të përdorin shërbimet e qendrave të zhvillimit, por, në realitet, njerëzit shpesh qëndrojnë më gjatë për shkak të numrit të vogël të alternativave të bazuara në komunitet. Rreth 100 të rritur me aftësi të kufizuara intelektuale janë të detyruar të jetojnë në spitalet psikiatrike, sepse ata nuk kanë familje që të mund të kujdeset për ta dhe nuk ka shërbime sociale të përshtatshme në dispozicion.

Hendeku më i madh në ofrimin e shërbimeve në Shqipëri qëndron në **shërbimet me bazë komunitetin**, çka do t'u mundësonin personave me aftësi të kufizuara të bënin një jetë të pavarur në komunitetet e tyre. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara ofrohen në strehat ose në qendrat e kujdesit ditor, të cilat mbështeten kryesisht nga shoqëria civile dhe programet vullnetare. Legjislacioni nuk lejon prokurimin e shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile, edhe pse rishikimi i tanishëm i Ligjit për Shërbimet Shoqërore mund ta bëjë të mundur këtë dhe të ngrejë një mekanizëm financimi. Gjithashtu, po përcaktohet një

⁴⁷ Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, Raporti i Vlerësimit - Strategjia Kombëtare Ndërsektorale për Përfshirjen Sociale në Shqipëri, 2007-2013, botuar në vitin 2012, f. 24.



shportë e shërbimeve bazë nëpërmjet ligjit të ri “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore”. Për momentin, mungesa e shërbimeve të bazuara në komunitet bën që personat me aftësi të kufizuara t’i drejtohen ofruesve privatë kur ata mund t’i përballojnë këto shërbime dhe kontribuon për institucionalizimin dhe ndarjen e personave me aftësi të kufizuara nga familjet e tyre.

Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” përcakton shërbimet e nevojshme për të nxitur jetesën e pavarur, duke përfshirë ndihmën personale, pajisjet dhe mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesibilitetit, duke përfshirë transportin, përshtatjen e arsyeshme, dhe, kur është e nevojshme, mbështetjen në vendimmarrje⁴⁸. Këto shërbime duhet të mbështeten me udhëzime procedurale dhe financime të përshtatshme.

1.6 Kujdesi shëndetësor

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta të barabarta për akses në kujdesin shëndetësor cilësor njëloj si pjesa tjetër e popullsisë dhe në programe rehabilitimi falas në komunitetin e tyre. Ata gëzojnë të drejtën për rimbursim të barnave dhe për kujdes shëndetësor falas⁴⁹.

Një nga nismat reformuese më të rëndësishme është kalimi nga përcaktimi mjekësor i aftësive të kufizuara te **modelibio-psiko-social**, që përfshin rishkrimin e kriterëve për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar⁵⁰, prezantimin e një qasjeje multidisiplinore, krijimin e strukturave të nevojshme, reformimin e përfitimeve dhe të së drejtës për të përfituar nga skemat pa kontributin e punëmarrësit, si dhe dixhitalizimin e informacionit dhe të komunikimit. Përbërja e komisioneve parësore dhe atyre eprore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar po reformohet për t’i bërë ato multidisiplinore. Njëkohësisht po punohet për listën e diagnozave për të përcaktuar në mënyrë më të përshtatshme shkaqet e mundshme të aftësisë së kufizuar. Kjo punë filloi në vitin 2014 me mbështetjen e Projektit të Bankës Botërore për Modernizimin e Ndhmës Sociale⁵¹. Në vitin 2016, sistemi i ri do të zbatohet si pilot në 2 qarqe, duke përfshirë strukturat e reja në nivel vendor.

Gjatë periudhës së mëparshme, ka patur një fokus në **parandalimin dhe vlerësimin e hershëm të aftësisë së kufizuar**. Në disa lokalitete (sidomos në zonat rurale), ekziston një mungesë instrumentesh dhe specialistësh të nevojshëm për vlerësimin e hershëm. Materialet informative dhe fushata për parandalimin e aftësive të kufizuara duhet të

48 Neni 6.

49 Raporti i parë i progresit i qeverisë shqiptare mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, maj 2015, f. 20.

50 Bazuar në modelin konceptual të OBSH-së për klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësive të kufizuara dhe shëndetit.

51 Më shumë detaje në lidhje me këtë projekt gjenden në faqen e internetit të Bankës Botërore në: <http://www.worldbank.org/projects/P122233/social-assistance-modernization-project?lang=en>.

vazhdohen. Mjekët e kujdesit shëndetësor parësor morën një protokoll për të referuar fëmijët për vlerësim, nëse ishte e nevojshme. Administratorët socialë/Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve mbajnë kontakte të rregullta me familjet, por kanë mungesë kapacitetesh që t'i referojnë fëmijët në mënyrë të vazhdueshme. Shpesh mësuesit kërkojnë vlerësim kur fëmija arrin në moshën për shkollë dhe përballet me vështirësi të ndryshme

Shërbimet për personat me çrregullime të shëndetit mendor synojnë të parandalojnë institucionalizimin dhe të ofrojnë aktivitete të përqendruara në parandalim, trajtim dhe rehabilitim në komunitetin lokal⁵². Ministria e Shëndetësisë dhe OBSH-ja kanë trajnuar në mënyrë aktive mjekët dhe infermieret për kuadrin rregullator dhe të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor. Qendrat e shëndetit mendor funksionojnë vetëm nëpër qytete të mëdha, megjithëse Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri (2013-2022) ofron një sistem të integruar të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të gjitha rajonet. Edhe mjekët e familjes kanë rëndësi thelbësore në identifikimin e hershëm, referimin dhe trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Lidhur me **ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara në burgje**, në vitin 2014, qeveria ka siguruar mbulimin me sigurim shëndetësor falas përmes miratimit të ligjit "Për trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve". Edhe problemi i furnizimit me medikamente dhe i konsultimeve mjekësore dhe psikiatrike është trajtuar në një udhëzim të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe në një Memorandum Bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Megjithatë, nuk ka një psikiatër në çdo burg ku menaxhohet dhe administrohet mjekim. Nuk ka objekte për trajtimin e shëndetit mendor të urdhëruar nga gjykata, si rrjedhim, njerëzit nën këtë regjim vendosen në burg.

Ministria e Shëndetësisë po punon për të përmirësuar **aksesueshmërinë në qendrat e kujdesit shëndetësor dhe në spitale**. Ajo ka kryer një kontroll për aksesueshmërinë dhe do të miratojë një plan për investime. Gjithashtu, ministria në buxhet ka përcaktuar fonde për të përmirësuar aksesueshmërinë dhe nuk do të miratojë asnjë plan për rinovim që nuk pajtohet me standardet e kësaj fushe.

Shërbimet e rehabilitimit dhe të trajtimit të ofruara në Shqipëri janë të kufizuara në numër dhe llojshmëri, të paaksesueshme për shumicën e personave me aftësi të kufizuara dhe/ose jofunksionale, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shumica e personave me aftësi të kufizuara duhet t'u drejtohen ofruesve të shërbimeve private. Personat me çrregullime të shëndetit mendor mund të kenë akses në shërbimet e rehabilitimit dhe të trajtimit në Qendrat e Shëndetit Mendor në Komunitet (QSHMK), të cilat ofrojnë shërbim ambulator. Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve në Kombinat ofron shërbim 0-6 vjec.

52 Neni 13 i ligjit nr. 44/122 "Për shëndetin mendor".



1.7 Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Pjesëmarrja në jetën politike është thelbësore për kuptimin e të drejtave themelore dhe mbrojtjen për personat me aftësi të kufizuara. Aktualisht, nuk ka asnjë person me aftësi të kufizuara që të jetë deputet ose ministër dhe është vetëm një zëvendësministre grua me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ka pengesa për të marrë pjesë në procesin e votimit duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e qendrave të votimit janë të paaksesueshme. Gjendja është akoma më e rëndë në rastet e atyre personave me aftësi të kufizuar të cilët e kanë të pamundur të dalin nga shtëpia e për pasojë e kanë të pamundur të marrin pjesë në procesin zgjedhor, me qëllim plotësimin e një të drejte bazë themelore të njeriut. Kjo për shkak të pengesave që dalin nga përcaktimet në Kodin Zgjedhor aktual dhe procedurave administrative për të siguruar akses në procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuara në banesën vetjake.

Komisioni Qëndror i zgjedhjeve për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2013 ndërtoi një bazë të plotë të dhënash për qendrat e votimit, ku janë të regjistruar zgjedhës PAK, numri i tyre, lloji i paaftësisë si dhe aksesueshmëria e tyre. Kjo bazë të dhënash u përditësua në zgjedhjet vendore në 2015 dhe është përcjellë edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe në Ministrinë e Shëndetësisë (shumica e qendrave të votimit caktohen në shkolla dhe qendra shëndetësore). Në këto objekte publike të identifikuar nga KQZ , aksesueshmëria duhet të realizohet me prioritet , pasi përtej nevojave të përditshmërisë, duhet të krijohen kushtet për plotësimin e të drejtës themelore të zgjedhësve PAK për të votuar , me qëllim që ata të jenë të barabartë me qytetarët e tjerë.

Në kuadër të procesit të politikëbërjes publike, ligji për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara përcakton *“Pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara”*. I njëjti ligj përcakton gjithashtu edhe grupet e ndryshme të aktorëve që duhet të përfshihen në konsultime, përkatësisht:

- a) individët me aftësi të kufizuara;
- b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara (ku personat me aftësi të kufizuar ose prindërit e tyre gëzojnë shumicë të cilësuar në vendimmarrje);
- c) organizatat për persona me aftësi të kufizuara;
- d) organizatat e përfaqësuar në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar **u ngrit si një strukturë në zbatim të ligjit “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara”** dhe filloi funksionimin në Prill 2015. Në ndryshim nga e kaluara, ky Këshill është tashmë i sanksionuar

me ligj, me detyra dhe funksione ligjore të përcaktuara qartë. Në këtë Këshill, numri i antarëve që vijnë nga organizatat e PAK përbëjnë 41 % të antarëve të tij, nga të cilat 43 % janë femra, duke realizuar kështu nivelin më të lartë të përfaqësimit të tyre deri tanidhe ruajtjen e balancës gjinore në përfaqësim.

Gjatë procesit të zhvillimit të Planit të Veprimit janë kryer konsultime me të gjithë këta aktorë.⁵³

Në fushën e **kulturës**, qeveria ka dhënë fonde për aktivitete të veçanta, në përputhje me ligjin e vitit 2010 “Për artin dhe kulturën”. Gjatë verës së vitit 2014, qeveria mbështeti projektin “Inclusive Art Lab”, i cili u vu në jetë nga OJQ-ja “Art Link”, në Durrës, me pjesëmarrjen e rreth 80 personave me aftësi të kufizuara. Projekti ofroi trajnim për aksesimin në fondet publike në fushën e artit dhe kulturës.

“Muzeu |Historik Kombëtar” në vitin 2015 ka organizuar 4 aktivitete “Edukimi përmes trashëgimisë kulturore” me nxënësit me aftësi të kufizuara. Muzeu Arkeologjik Durrës dhe Digitalb kanë organizuar ekspozitën “Pa dritë” ku përmes prekjes së objekteve të riprodhuara arkeologjike dhe tabelave shpjeguese me shkrimin Brail, personat me aftësi të kufizuara mund të kryejnë vizitë në mjediset e këtij institucioni. Për projektet në vazhdim të vitit 2016, Ministria e Kulturës ka mbështetur financiarisht në shumën 300,000 (Treqind mijë) Lekë projektin Bunkerplis, paraqitur dhe organizuar nga Persona me Aftësi të Kufizuara.

Projektligji i ri “Për trashëgiminë kulturore” do t’i detyrojë institucionet e trashëgimisë kulturore të sigurojnë akses për personat me aftësi të kufizuara. Muzeu Historik Kombëtar dhe Teatri i Operës dhe Baletit kanë ndërtuar rampa në hyrje për të nxitur aksesueshmërinë. Gjithashtu, për personat me aftësi të kufizuara çmimet e biletave janë më të ulëta. Nisma e re “Edukimi nëpërmjet kulturës” do të lehtësojë vizitat e organizuara të nxënësve nëpër muze, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në fushën e **sporteve**, Komiteti Olimpik Special është përgjegjës për organizimin e aktiviteteve sportive për personat me aftësi të kufizuara. Olimpiada Speciale e fundit u mbajt në vitin 2012. Sportistët me aftësi të kufizuara ishin pjesë e delegacioneve shqiptare në takimet ndërkombëtare të Komitetit Olimpik. Një person me aftësi të kufizuara është gjithashtu anëtar i Komitetit Kombëtar të Sporteve që ka rol këshillues.

Organizatat e shoqërisë civile organizojnë aktivitete të rregullta, të tilla si Kampionati i Basketbollit i Karrigeve me rrota dhe aktivitetet e Javës Evropiane të Lëvizjes, por nuk ka një federatë zyrtare të sportistëve me aftësi të kufizuara. Qeveria është duke përfunduar një Ligj të ri mbi Sportet i cili do të mundësojë krijimin dhe financimin e kësaj federate. Disa nga 22 federatat sportive ekzistuese zhvillojnë gjithashtu aktivitete që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara. Udhëzimi nr. 4 i datës 11 mars 2014, përcakton kritere për dhënien e

⁵³ Shoqatat e personave me aftësi të kufizuara kanë vështirësi me qëndrueshmërinë financiare, edhe pse disa marrin financim nga shteti. Në përgjithësi, ata kanë pak mundësi për të paguar tarifat e anëtarësisë dhe financimi nga donatorë është i përkohshëm dhe i bazuar në projekte. Shumë shoqata nuk kanë as zyra dhe janë të regjistruara në adresën e shtëpisë së presidentit. Me qëllim trajtimin efikas të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, ato kërkojnë kapacitete financiare, teknike dhe burimesh njerëzore shtesë. Ata kanë mungesë ekspertize për negocimin dhe për zhvillimin e rrjeteve, si dhe mungesë në aftësitë për advokim, koordinim dhe organizim të brendshëm. Si rezultat, ndikimi i tyre në zhvillimin e politikave dhe në vendimmarrje është relativisht i kufizuar.



fondeve federatave sportive, duke cilësuar “përfshirjen në projekte të personave me aftësi të kufizuara».

Përveç kësaj, qendrat e zhvillimit organizojnë aktivitete sportive dhe kulturore me përfituesit e tyre. Megjithatë, del nevoja për infrastrukturë dhe kapacitete më të mira për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme të mund të marrin pjesë në mësimin e edukimit fizik dhe aktivitetet sportive.

1.8 *Bashkëpunimi rajonal, monitorimi dhe vlerësimi*

Për të trajtuar çështjet komplekse dhe të ndërlydhura të përcaktuara më lart, qeveria e Shqipërisë do të kërkojë shembuj të praktikës së mirë nga kontekste të ngjashme nëpërmjet bashkëpunimit rajonal. Nevojiten njohuri të specializuara (për shembull, për të hartuar rregullore për vendimmarrje të mbështetur ose për të krijuar një sistem pilot për strehimin në një mjedis mbështetës ose për asistentët personalë) për të siguruar përputhshmërinë me dispozitat e Konventës së OKB-së. Edhe shërbimet ekzistuese duhet të përmirësohen dhe të zgjerohen në nivel komuniteti. Për t’i nisur këto reforma, Shqipëria do të marrë përvojë nga vende të tjera dhe do të shkëmbejë mësimet që ka nxjerrë ajo gjatë procesit.

Veprimtaritë në fushën e monitorimit dhe të vlerësimit përshkruhen në kapitullin 5.





2



Vizioni, Politikat dhe Qëllimet Strategjike

2. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Qëllimi i këtij Plani Veprimi të qeverisë është të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe t'u eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet dhe të drejtat e tyre. Nëpërmjet zbatimit të tij, Qeveria e Shqipërisë do të përmirësojë aksesueshmërinë e informacionit dhe shërbimeve publike, do të lehtësojë arsimin gjithëpërfshirës, do të aplikojë një vlerësim të ri të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social dhe do të zgjerojë shërbimet sociale me bazë në komunitet, shërbimet e rehabilitimit dhe masat për nxitjen e punësimit.

Gjithashtu, Plani i Veprimit parashikon aktivitete që synojnë përmirësimin ose zgjerimin e programeve ekzistuese (siç janë arsimi dhe formimi profesional, punësimi, shërbimet sociale, programet gjithëpërfshirëse të arsimit, ndihma juridike falas, etj). Një prej aspekteve të tij të rëndësishme është edhe nxitja e zbatimit të standardeve që janë miratuar tashmë nga qeveria, kryesisht në fushën e aksesueshmërisë fizike.

Qëllimet strategjike të Planit të Veprimit janë:

- ▶ Të realizohet aksesueshmëria për shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.
Synimi: Deri në vitin 2020 të gjitha godinat ku ofrohen shërbime publike të jenë të aksesueshme.
- ▶ Të garantohet akses në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.
Synimi: Deri në vitin 2020, institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të sigurojnë akses të barabartë në përfitimin e ndihmës ligjore falas, në qasjen e proceseve gjyqësore duke përfshirë edhe ofrimin e interpretimit në gjuhën e shenjave.
- ▶ Të rritet pjesëmarrja në tregun e punës dhe të promovohen mundësi të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara.
Synimi: Deri në vitin 2020, numri i PAK që punësohen nga zyrat e punësimit nëpërmjet programeve specifike të nxitjes së punësimit të rritet cdo vit me 50% si dhe të rritet numri i të rinjve me AK që punësohen në administratën shtetërore.
- ▶ Të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.
Synimi: Deri në vitin 2020, të gjitha Komisionet Multidisiplinare të Arsimit për vlerësimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe të rritet numri i mësuesve ndihmës të rekrutuar në përputhje me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- ▶ Të përmirësohet cilësia e jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht, të fokusuar te

klienti dhe sa më pranë tij në komunitet.

Synimi: Deri në vitin 2020, të ketë filluar aplikimi i vlerësimit të ri të PAK sipas modelit bio-psiko-social nga komisionet e reformuara dhe të rritet numri dhe llojet e shërbimeve shoqërore në komunitet duke përfshirë edhe ato të jetesës së pavarur.

- ▶ Të sigurohet një kujdes shëndetësor i aksesueshëm, i përballueshëm dhe i barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

Synimi: Deri në vitin 2020, të rritet numri dhe lloji i mjeteve ndihmëse të rimbursuara nga shteti për PAK sipas nevojave dhe të realizohet sigurimi i funksionimit të një Qendre Kombëtare të Reabilitimit.

- ▶ Të mundësohet për personat me aftësi të kufizuara që të përfaqësojnë interesat e tyre dhe të marrin pjesë në jetën publike dhe politike në Shqipëri.

Synimi: Deri në vitin 2020, të rritet numri i PAK që marrin pjesë në procesin e votimit dhe që përfaqësohen në Këshillat bashkiakë nëpërmjet një pjesëmarrjeje më të madhe në jetën politike.

- ▶ Të krijohen sinergji midis sektorëve të ndryshëm për nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Arritja e këtyre qëllimeve kërkon ngritjen e strukturave të reja në nivel qendror dhe vendor, si p.sh. zyrat e vlerësimit të nevojave, komisionet multidisiplinore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe koordinimin e shërbimeve të ofruara nga institucionet qendrore dhe nga Bashkitë. Një rëndësi të vecantë ka edhe ngritja dhe institucionalizimi i pikave fokale që punojnë për aftësinë e kufizuar në nivel qendror dhe vendor. Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile ka gjithashtu rëndësi themelore, pasi ato mund të rrisin ndërgjegjësimin rreth proceseve të reformave te personat me aftësi të kufizuar, si dhe ofrimin e ekspertizës për zhvillimin e standardeve dhe shërbimeve të reja.



3



Objektivat e Politikave dhe Produktet Kryesore



3. OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE PRODUKTET KRYESORE

Për çdo qëllim strategjik, Plani i Veprimit përcakton disa objektiva të ndryshme që duhet të arrihen, me qëllim trajtimin e problemeve në një mënyrë gjithëpërfshirëse. Çdo objektiv zbatohet nëpërmjet zakonisht 10-20 aktiviteteve konkrete. Ndërsa qëllimet strategjike janë më të zgjeruara dhe do të kërkojnë një periudhë më të gjatë që të arrihen, objektivat duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të Planit të Veprimit (2016-2020). Aktivitetet e planifikuara duhet të vazhdojnë edhe pas kësaj periudhe dhe në vitin 2020 mund të shtohen aktivitete të reja.

Objektivat dhe produktet kryesore sipas fushave prioritare të Planit të Veprimit janë:

Aksesueshmëria

Qëllimi strategjik 1. Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi 1: Përmirësimi i aksesueshmërisë fizike të shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara

Ndërsa legjislati i përmirësuar për standardet e aksesueshmërisë janë miratuar tashmë nga qeveria, ato shpesh nuk zbatohen në praktikë për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit, kapacitetit teknik ose kufizimeve infrastrukturore dhe financiare. Ministritë dhe institucionet që nuk kanë informacion të hollësishëm dhe sistematik rreth aksesueshmërisë së ambienteve të tyre dhe institucioneve të vartësisë (në të gjithë vendin) do të kryejnë një vlerësim të nivelit të aksesueshmërisë. Ky vlerësim mund të kryhet mbi bazën e një modeli godinash (në varësi të financimit në dispozicion) dhe ekipi i kontrollit duhet të përmbajë ekspertë të arkitekturës, inxhinierisë dhe të projektimit universal. Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë gjithashtu pjesë e ekipit. Ekspertët duhet të ndërgjegjësohen për mjetet e ndryshme që mund të përdoren për të përmirësuar aksesueshmërinë e godinave ekzistuese. Rezultatet e vlerësimit do të përdoren nga ministritë për të priorizuar financimin e tyre për përmirësimin e aksesueshmërisë, si dhe për kërkimin e donatorëve për projekte konkrete në këtë fushë. Një nga drejtimet në këtë fushë ka të bëjë me përmirësimin e aksesueshmërisë së qendrave të kujdesit rezidencial duke qenë se jo të gjitha ato janë ndërtuar në përputhje me standardet e aksesueshmërisë (p.sh. tualetet, fjetoret, kuzhina dhe mjediset e tjera të shërbimeve, mjediset e përbashkëta, etj).



Lidhur me monitorimin e zbatimit të aksesueshmërisë, MMSR do të organizojë trajnime për inspektorët që do të monitorojnë zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë nga subjektet publike në nivel qendror dhe vendor.

Objektivi 2: Përmirësimi i aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara

Fokusi i aktiviteteve nën këtë objektivi do të jetë në përgatitjen e standardeve të reja për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe portaleve qeveritare (duke përfshirë aksesin në shërbimet elektronike që janë duke u përgatitur tashmë nga qeveria). Gjithashtu, Ministria e Kulturës do të marrë rol lider në futjen e pajisjeve audio/dixhitale dhe gjuhën e shenjave nëpër muze, ndërsa Biblioteka Kombëtare do të rrisë numrin e librave të disponueshëm në formate dixhitale dhe alfabetin Braille. Qeveria do të bashkëpunojë gjithashtu me përfaqësues të shoqërisë civile për zhvillimin e një sistemi trajnime dhe arsimit për interpretë të gjuhës së shenjave në mënyrë që ata të futen në institucione publike.

Objektivi 3: Aksesueshmëria e transportit publik për çdo individ

Ndërsa zbatimi i standardeve të aksesueshmërisë së transportit urban nuk hyn nën mandatin e qeverisë qendrore, është e nevojshme që sistemet e monitorimit në këtë fushë të forcohen. Ky hap përfshin mekanizmat e lehtësuar nga institucione të pavarura që mund të reagojnë ndaj shkeljeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për transport të aksesueshëm dhe financiarisht të përballueshëm.

Barazia

Qëllimi strategjik 2. Të garantohet akses në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi 1: Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara, të kualifikueshëm për ndihmë juridike falas, që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas

Personat me aftësi të kufizuara aktualisht përdorin shumë rrallë shërbime të ndihmës juridike falas, pra është e nevojshme që kuadri ligjor përkatës të harmonizohet me Konventën e Kombeve të Bashkuara, me qëllim rritjen e aksesit për marrjen e këtij shërbimi ëj vetëm nga pikëpamja infrastrukturore, por edhe që personeli që ofron ndihmën juridike të ketë kapacitetet për trajtimin e çështjeve të paraqitura nga personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi 2: Sigurimi i barazisë para ligjit të të gjithë personave me aftësi të kufizuara.

Ky grup aktiviteteve fokusohet në njohjen e zotësisë për të vepruar të personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojë që ata të marrin pjesë si palë në procedimet për heqjen e zotësisë për të vepruar, me qëllim harmonizimin e legjislacionit shqiptar me standardet



ndërkombëtare. Gjithashtu, është e nevojshme që të shqyrtohen praktika të mira në fushën e vendimmarrjes së mbështetur, që është futur nëpërmjet ligjit “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” dhe se si duhet të përfaqësohet një alternativë e kujdestarisë ligjore.

Objektivi 3: Garantimi që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë të respektohen në përputhje me standardet ndërkombëtare

Qeveria do të monitorojë arritjen e shërbimeve gjyqësore, noteriale e avokatie për personat me aftësi të kufizuara. Qeveria do të sigurojë ambiente dhe shërbime të reja për personat me aftësi të kufizuara që janë në (para)-burgim, duke përfshirë ambiente të specializuara për trajtimin shëndetësor mendor të urdhëruar nga gjykata, transferimin e të burgosurve nga burgu i Zaharisë në Krujë dhe ofrimin e mbikëqyrjes psikiatrike në institucionet ku duhet të menaxhohet dhe administrohet mjekimi.

Punësimi dhe Aftësimi

Qëllimi strategjik 3 : Të rritet pjesëmarrja në tregun e punës dhe të promovohen mundësi të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi 1: Përmirësimi i cilësisë dhe shtrirjes së shërbimeve të AFP-së që nxisin përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës

Personat me aftësi të kufizuara do të mund të ndjekin të gjitha kurset e arsimit dhe formimit profesional , të cilat synohet të jenë të aksesueshme për të gjithë kategoritë e PAK. Gjithashtu, qeveria do të bëjë përpjekje për të siguruar formim profesional dhe aftësi për jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi 2: Lehtësimi i integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit

Nëpërmjet ndërhyrjeve legislative, qeveria do të përmirësojë programet aktive të tregut të punës me anë të ofrimit të masave më afatgjata të shoqëruara me mbështetje fleksibël (p.sh. vizita javore gjatë gjashtë muajve të parë në vendin e punës, ndërmjetësim në rast të ndonjë problemi). Gjithashtu, duhet të rishikohen përfitimet në fushën e punësimit, për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me nevojat e tyre.

Objektivi 3: Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të institucioneve dhe shërbimeve të punësimit që synojnë nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

Me qëllim trajtimin e pengesave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara për



gjetjen e një pune, qeveria do të nxisë pjesëmarrjen e tyre në programet e rregullta që u mundësojnë të rinjve me AK të fitojnë përvojë profesionale në sektorin privat dhe publik. Gjithashtu, Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të përfshijë kritere, synime dhe parime të lidhura me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në sistemin e Menaxhimit të Performancës dhe Garantimit të Cilësisë. Aksesit në shërbime dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara do të trajtohen në planin e zhvillimit dhe rekrutimit të personelit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Arsimimi

Qëllimi strategjik 4 : Të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Objektivi 1: Përmirësimi i cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara

Thelbi i reformave në këtë sektor do të përbëhet nga futja e komisioneve multidisiplinore të arsimit, futja e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkolla të zakonshme dhe përgatitja e materialit të ri didaktik. Do të vendoset ndjekja individuale dhe koordinimi midis ministrive të ndryshme, me qëllim që të garantohet arsimimi i çdo fëmije me aftësi të kufizuar.

Objektivi 2: Transformimi i shkollave të specializuara në qendra burimore

Shkollat speciale do të transformohen në qendra burimore, me qëllim nxitjen e zhvillimit profesional të mësuesve dhe mësuesve ndihmës të shkollave të zakonshme, të cilët do të punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë parashikohet se një numër më i madh i fëmijëve me aftësi të kufizuara do të mund t'i bashkohen sistemit arsimor të zakonshëm.

Kujdesi social

Qëllimi strategjik 5 : Të përmirësohet cilësia e jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht, të fokusuara te klienti dhe sa më pranë tij në komunitet.

Objektivi 1: Përmirësimi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar me anë të kalimit nga modeli mjekësor në modelin bio-psiko-social

Me qëllim zëvendësimin e modelit mjekësor për vlerësimin e aftësisë së kufizuar me



modelin bio-psiko-social, qeveria do të pilotojë zyrapër vlerësimin e AK në rajonet e përzgjedhura dhe më pas do t'i fusë ato në mbarë vendin. Ky proces afatgjatë do të kërkojë trajnim të personelit, rritje të ndërgjegjësimit të personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre rreth procesit të ri dhe rishikim të kuadrit ligjor.

Objektivi 2: Ofrimi i shërbimeve sociale të integruara me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë dhe kujdesit social cilësor

Përveç vazhdimit të ofrimit të pagesave me para në dorë, është e nevojshme që të ofrohet një grup i zgjeruar shërbimesh rezidenciale duke tentuar në rritjen e shërbimeve komunitare. Në veçanti, personat me aftësi të kufizuara intelektuale mbi 25 vjeç nuk kanë akses në shërbime dhe, në disa raste, mbyllen në spitale psikiatrike.

Objektivi 3: Nxitja e deinstitutionalizimit nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet

Me qëllim nxitjen e zhvillimit të shërbimeve të bazuara në komunitet, qeveria do të përgatisë modalitete të reja prokurimi (edhe për ofruesit e shoqërisë civile), do të rrisë numrin e ofruesve të licencuar dhe do të krijojë një mekanizëm financues.

Objektivi 4. Të modelohen, për të rriturit > 25 vjeç me AK intelektuale, shërbime të posacme që do të ofrohen në qendra ditore apo në familje me qëllim integrimin në punësim dhe jetesën e pavarur

Kujdesi shëndetësor

Qëllimi strategjik 6 : Të sigurohet një kujdes shëndetësor i aksesueshëm, i përballueshëm dhe i barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara

Ministria e Shëndetësisë do të kërkojë të forcojë kapacitetet e personelit të saj për ofrimin e shërbimeve të fokusuar tek klienti. Gjithashtu, ajo do të ofrojë një rregullore të brendshme për lehtësimin e vizitave mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet në familje.

Objektivi 2: Zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, integritit dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara

Qeveria do të pilotojë një model për ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit për PAK në nivel lokal dhe do të ngrëjë një Qendër Kombëtare Rehabilitimi. Ajo do të mbështesë aktivitetet që synojnë parandalimin e aftësive të kufizuara dhe do të ofrojë një paketë bazë shërbimesh për fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim që t'i ndihmojë për të arritur dhe



për të ruajtur funksionimin optimal në ndërveprim me mjediset e tyre.

Objektivi 3. Të planifikohen buxhetet për sigurimin e mjeteve ndihmëse (karrige me rrota, aparate dëgjimi, etj)

Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Qëllimi strategjik 7 : Të mundësohet për personat me aftësi të kufizuara që të përfaqësojnë interesat e tyre dhe të marrin pjesë në jetën publike dhe politike në Shqipëri.

Objektivi 1: Mundësimi i personave me aftësi të kufizuara për të votuar, advokuar për interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje

Në këtë fushë duhet të bëhet përpjekje e madhe për përmirësimin e aksesit në votim, jo vetëm me anë të krijimit të qendrave të aksesueshme të votimit, por edhe nëpërmjet përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në monitorimin e zgjedhjeve. Kjo e fundit do të kërkojë ngritje kapacitetesh të individëve me AK. Gjithashtu, përdorimi i gjuhës së shenjave në media duhet të rritet.

Objektivi 2: Nxitja e punës së artistëve me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në jetën artistike

Ministria e Kulturës do të vazhdojë të nxisë projektet e personave me aftësi të kufizuara, do të përmirësojë aksesin në informacion rreth përmbajtjes artistike apo përmbajtjes tjetër kulturore dhe do të lehtësojë vizitat e personave madhorë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione nën varësinë e saj.

Objektivi 3: Ofrimi i mundësive për personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në aktivitete dhe evente sportive

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të krijojë një mjedis mbështetës për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive. Përveç përmirësimit të aksesueshmërisë së ambienteve sportive, ministria është duke rishikuar edhe kuadrin ligjor, me qëllim lehtësimin e krijimit dhe financimit të një federate zyrtare të sportistëve me aftësi të kufizuara. Ministria do të vazhdojë të organizojë evente të Lojërave Olimpikë Speciale dhe do të mbështesë pjesëmarrjen e sportistëve me aftësi të kufizuara në garat dhe takimet ndërkombëtare.



Nxitja e bashkëpunimit dhe monitorimi e vlerësimi

Qëllimi strategjik 8 : Të krijohen sinergji midis sektorëve të ndryshëm për nxitjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Objektivi 1: Sigurimi i një bashkëpunimi dhe koordinimi më të mirë për projektimin dhe monitorimin e aktiviteteve mes MMSR-së dhe gjithë Bashkive.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet hartimit dhe aplikimit të një Guide Metodologjike do të mbështesë Bashkitë për hartimin dhe zbatimin e planeve të tyre të veprimit për përfshirje të personave me aftësi të kufizuara. Fokus të vecantë do të ketë ngritja e kapaciteteve të punonjësve të njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve që do të krijohen në bashki. Ajo do të monitorojë gjithashtu zbatimin e standardeve dhe ligjeve ekzistuese në nivel vendor. Bashkërendimi i punës do të fillojë me përcaktimin e pikës fokale për aftësinë e kufizuar në çdo bashki si një detyrim ligjor.

Objektivi 2: Monitorimi i pabarazive me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe koordinimi i politikave publike që synojnë reduktimin e tyre.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të koordinojë botimin e raporteve vjetore për zbatimin e Planit të Veprimit bazuar në informacionin e mbledhur gjatë vizitave në terren, takimet me organizata të shoqërisë civile dhe kontributet nga pikat e kontaktit për aftësinë e kufizuar pranë ministrive përkatëse të linjës. Ministri do të drejtojë Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar dhe stafi teknik do të përgatisë të dhënat për takimet e Këshillit. Ministria do të mbështesë gjithashtu botimin e raporteve hije nga organizatat e shoqërisë civile, duke dhënë informacionin e nevojshëm.

Objektivi 3: Ngritja e sistemit për mbledhjen e indikatorëve të monitorimit të shoqëruar me pasaportat për çdo indikator

Një nga sfidat e rëndësishme të kuadrit monitorues është mbledhja dhe përmirësimi i cilësisë së të dhënave në nivel qendror dhe vendor. Ekziston nevoja për të mbledhur të dhëna empirike për pozicionin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, si p.sh. niveli i varfërisë, pozicioni në punësim dhe arsimim, nevojat për shërbime të bazuara në komunitet dhe çështje të tjera. Kuadri ekzistues i monitorimit mund të forcohet me anë të një **sistemi online për raportimin e treguesve të monitorimit dhe progresit**. Kjo kërkon hartimin e një metodologjie të caktuar jo vetëm për të ndërtuar setin e nevojshëm të indikatorëve që nasin progresin por edhe të pasaportave respektive të tyre.

Objektivi 4 : Nxitja e bashkëpunimit rajonal për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Qeveria do të organizojë konferenca rajonale dhe do të marrë pjesë në shkëmbimin e praktikave të mira jashtë vendit. Ajo do të përfshijë persona me aftësi të kufizuara në delegacionet e saj për eventet ndërkombëtare.





4




Burimet Finanziare

4. BURIMET FINANCIARE

Buxheti për Planin e Veprimit përfshin koston e aktiviteteve të specifikuar në matricë, të cilat promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministrinë përkatëse të linjës. Në disa raste, buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, kështu që Plani i Veprimit përfshin një ndarje të hendekut të financimit si dhe propozimin për fonde donatorësh. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për nxitjen e përfshirjes në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në këtë Plan Kombëtar Veprimi, i cili fokusohet në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore.

Efektin financiar për zbatimin e Planit të Veprimit për PAK 2016-2020, bazuar në kostimin e aktiviteteve është përllogaritur të jetë 1,983,043,059 ALL nga të cilat



Në varësi të llojit të aktivitetit, Plani i Veprimit specifikon:

1. Financimi nga shteti:

Aksionet që synojnë veçanërisht personat me aftësi të kufizuara (të tilla si financimi i organizatave të personave me aftësi të kufizuara), zakonisht kanë një (nën)zë të veçantë në buxhet. Në të kundërt, buxheti përcaktohet duke shumëzuar koston mesatare për përfitues me numrin e përfituesve. Nëse numri i përfituesve nuk dihet, kostoja llogaritet në mënyrë të përafërt (duke marrë parasysh që kjo është vetëm një përllogaritje e përafërt).

Aktivitetet që mbulohen nga buxheti i përgjithshëm i shtetit – llogaritjet bëhen në bazë të numrit (të deklaruar) të përfituesve me aftësi të kufizuara. Kostimi i të gjitha aktiviteteve sipas sektorëve respektivë është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë e Buxhetit të çdo ministrie duke patur si referencë Projekt Buxhetin Afat-mesëm 2016-2018. Për vitet 2019 dhe 2020 kostimi është bërë me përllogaritje të afërt. Për një buxhetim më të

saktë të shtrirë në periudhën kohore deri 2020 , parashikohet që të bëhet një vlerësim i progresit afatmesëm të objektivave të Planit në vitin 2018 dhe një ribuxhetim i masave deri në vitin 2020.

- 2. Financimi nga donatorët** – nëse shpenzime të caktuara nuk mund të mbulohen nga buxheti i shtetit, bëhet një vlerësim për fondet e nevojshme nga donatorët dhe ky vlerësim përfshihet në matricë.
- 3. Kombinimi i financimit nga shteti dhe donatorët** – në disa raste, fondet e shtetit janë të disponueshme, por të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e aktiviteteve, kështu që në matricë përfshihen fondet publike dhe ato të donatorëve.
- 4. Pa kosto** (për shembull, në rastin kur aktiviteti kryhet si pjesë e detyrave funksionale të nëpunësve të administratës pa patur kosto shtesë për asistencë teknike).

Me synimin për të përcaktuar kostot reale të zbatimit të Planit të Veprimit, është patur kujdes për të mos rritur në mënyrë fiktive fondet shtetërore në dispozicion ose për të mos rritur vlerat për mbështetjen e nevojshme nga donatorët. Për të shpjeguar llogaritjen e koston, është përgatitur veçmas një raport argumentues për buxhetin.

Kostoja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në programet e nxitjes së punësimit, në programet e arsimit dhe formimit profesional (AFP), programet e pagesave të AK dhe ndihmës ekonomike janë llogaritur duke u bazuar sipas rastit në të dhënat e vitit 2014/2015 (dhe planifikimet/përlllogaritjet për 2016-2020), sepse këto programe janë thelbësore për nxitjen e integritit dhe përbëjnë thelbin e punës së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në buxhetin e Planit të Veprimit nuk reflektohen pagat e punonjësve që punojnë për zhvillimin ose zbatimin e politikave (specialistë politikash, mjekë, oficerë policie, nëpunës në zyrat e punësimit, apo nëpunës të tjerë të administratës që ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët) sepse kjo është pjesë e detyrave të tyre funksionale.


Gjithashtu buxhetet e njësive të qeverisjes vendore, do të pasqyrohen në Planet Lokale të Veprimit për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara (ndërsa plani kombëtar fokusohet në buxhetin qëndror).

Buxheti për koordinimin e politikave dhe raportimin është listuar në një pjesë të veçantë të matricës.

Një analizë e detajuar e kostimit të masave të Planit të Veprimit është bërë në Anexin 1.

Sektori	Totali i Buxhetit (Lek)	Buxheti i Shtetit (Lek)	Buxheti i Donatorit (Lek)
Aksesueshmëria	235,935,000	146,830,000	89,105,000
Barazia	76,375,000	60,600,000	15,775,000
Punësimi dhe Aftësimi dhe Formimi Profesional	69,072,360	52,672,360	16,400,000
Arsimi	499,685,000	465,750,000	33,935,000
Kujdesi social	180,556,619	153,238,000	27,318,619
Kujdesi Shëndetësor	745,775,000	568,200,000	177,575,000
Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike	77,044,000	50,544,000	26,500,000
Bashkëpunimi dhe Monitorim-Vleresimi	97,635,080	-	97,635,080
TOTALI	1,982,078,059	1,497,834,360	484,243,699

Ndarja e buxhetit sipas sektorëve





5



Llogaridhënia, Monitorimi
dhe Analiza e Vlerësimit

5. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA E VLERËSIMIT

5.1 Llogaridhënia

Institucionet respektive shtetërore në nivel qendror janë përgjegjëse për zbatimin e këtij Plani Veprimi. Për të rritur llogaridhënien, Plani i Veprimit përcakton Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si institucionin përgjegjës kryesor të raportimit për progresin e këtij Plani edhe pse pjesa më e madhe e veprimtarive do të kërkojë bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë shoqërinë civile dhe njësitë e qeverisjes vendore. Në 6 mujorin e parë të vitit 2017 do të hartohet Raporti i Parë i Monitorimit.

Plani i Veprimit specifikon gjithashtu për çdo veprimtari dhe objektiv një tregues monitorimi respektiv, të dhënat bazë kur janë të disponueshme dhe objektivat për 2017 dhe 2020. Për të patur një raport të plotë monitorimi dhe vlerësimi, nga ana e MMSR do të punohet në drejtim të një pasqyre të plotë të indikatorëve të monitorimit. Kjo kërkon hartimin e një metodologjie të caktuar për krijimin e pasaportave respektive të tyre me qëllim që monitorimi të jetë i unifikuar për të gjitha institucionet e përfshira. Në nivel politikash dhe objektivash strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate.

Procesi ekzistues i monitorimit mund të forcohet me anë të një **sistemi online për raportimin e treguesve të monitorimit dhe progresit**. Sistemi mund të ndjekë shembullin e platformës online RomALB të vendosur më parë për monitorimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve. Do të duhen përpjekje të dedikuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për t'u siguruar që të mblidhen rregullisht të dhënat dhe se këto sisteme përdoren nga të gjitha ministritë e linjës. Qeveria disponon kapacitete teknike dhe njerëzore për vënien në funksion të sistemeve të tilla, por nevojitet ndërgjegjësim dhe trajnim i vazhdueshëm për të siguruar që ato të përdoren në mënyrë efikase. Sistemi do të menaxhohet kryesisht nga MMSR, por do të jetë një sistem që do të përdoret për hedhjen e të dhënave nga bashkitë në të gjithë vendin dhe nga institucione të tjera shtetërore në nivel qendror e rajonal.

Gjithashtu, çdo veprimtari shoqërohet me afatin për zbatimin e saj dhe buxhetimin. Këto parametra do të mundësojnë monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit dhe vlerësimin e tij. Parashikohet se do të ketë një vlerësim afatmesëm në vitin 2018 me qëllim përditësimin e objektivave dhe masave dhe një vlerësim përfundimtar. Proceset e monitorim vlerësimit do të kryesohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si organi koordinues.

5.2 Monitorimi i Planit të Veprimit

Kuadri vlerësues dhe monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e resurseve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me Urdhërin e Kryeministrit Nr.129 datë 21.09.2015 "Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) të cilat monitorojnë reformat sektoriale në Shqipëri në përputhje me Prioritetet e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij Plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve në takimet e Nën Grupit Tematik të Përfshirjes Sociale që do të udhëhiqet nga MMSR dhe përberje të strukturave ndërsektoriale.

Bazuar në detyrimin ligjor, zbatimi i Planit të Veprimit monitorohet gjithashtu nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, i ngritur me Urdhërin nr. 12 të Kryeministrit, në shkurt 2015, dhe që përbëhet nga ministrat që mbulojnë sektorët përkatës. Aktualisht, Këshilli ka 17 anëtarë, nga të cilët 10 Ministra dhe shtatë anëtarë që janë persona me aftësi të kufizuar, pesë anëtarë që përfaqësojnë organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe dy anëtarë përfaqësues të organizatave që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet hartimit dhe aplikimit të një Guide Metodologjike do të mbështesë Bashkitë për hartimin dhe zbatimin e planeve të tyre të veprimit për përfshirje të personave me aftësi të kufizuara. Bashkërendimi i punës do të fillojë me përcaktimin e pikës fokale për aftësinë e kufizuar në çdo bashki si një detyrim ligjor.


Gjatë punës së përditshme, përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit qëndron te nëpunësit përgjegjës të ministrive të linjës që do të vënë në jetë aktivitetet, do të mbledhin të dhëna dhe do të dorëzojnë raportet e progresit për çdo sektor. Pothuajse të gjitha ministrat kanë identifikuar një nëpunës përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar bazuar edhe në Ligjin 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e PAK", por duhet të punohet për përgatitjen e disa termave të referencës për t'i përfshirë në përshkrimin detyrave të tyre të punës.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit. Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të jetë përgjegjëse për koordinimin e

aktorëve të ndryshëm dhe do të raportojë mbi zbatimin e Planit të Veprimit nëpër sektorë të ndryshëm bazuar në të dhënat nga ministrinë e linjës. Për këtë arsye, kapacitetet njerëzore të Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore duhet të forcohen me ekspertizë shtesë. Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të monitorojë zbatimin e Planit nëpërmjet vendosjes së kontakteve institucionale me të gjitha bashkitë e vendit, zhvillimit të takimeve të rregullta me përfaqësuesit e ministrive të ndryshme dhe shoqërisë civile, kryerjes gjatë vitit të vizitave në bashki të ndryshme, në mënyrë që të ketë menjëherë dijeni për ndjekjen e çështjeve të Aftësisë së Kufizuar dhe çdo sfidë tjetër që lidhet me të.

Plani i Veprimit parashikon publikimin e raport progresit vjetor gjatë 5 viteve të ardhshme dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Gjatë kohëzgjatjes së Planit të kaluar të Veprimit (2005-2015), nga ana e MMSR janë përgatitur disa raporte të përgjithëshme por të pabazuara në një proces dhe metodologji të mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi. Janë publikuar gjithashtu disa raporte nga organizatat e shoqërisë civile në mes të kohëzgjatjes së zbatimit, në periudhën 2009-2011, ku në një anketë të kryer me personat me aftësi të kufizuara, organizatat zbuluan se “aksesueshmëria mbetet një çështje e rëndësishme që përbën shqetësim për personat me aftësi të kufizuara me dëmtime të rënda motorike, të të shikuarit ose të të folurit, ku më shumë se 50 përqind e të cilëve thanë se ndihen të izoluar dhe të përjashtuar”⁵⁴.



54 Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, *Raporti i monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit për Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara në vitin 2010*, f. 14.

5.3 Mbledhja e të dhënave

Disponueshmëria dhe mbledhja e të dhënave paraqet një sfidë të rëndësishme për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit. Qeveria pranon rëndësinë e analizimit të të dhënave administrative sipas gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe etnisë, si tema ndërsektoriale për analizimin e varfërisë dhe mbrojtjes sociale, të punësimit dhe aftësive, arsimit, privimit material e pjesëmarrjes dhe të të drejtave të njeriut⁵⁵. Në përputhje me këtë qasje, do të punohet për mbledhjen dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave në nivel qendror dhe vendor . Të dhënat administrative përdoren nga ministritë për të monitoruar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në disa fusha, por kryesisht në programet e synuara të qeverisë. Megjithatë, ka të ngjarë që disa persona me aftësi të kufizuara të mos jenë të regjistruar si të tillë, dhe rrjedhimisht të mos jenë përfitues të këtyre politikave. Për të garantuar që të gjitha zyrat e qeverisë janë në gjendje të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të këtij Plani Veprimi, nevojitet edhe ngritja e mëtejshme e kapaciteteve.

Gjithashtu, ekziston nevoja për të mbledhur të dhëna empirike për pozicionin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, si p.sh. niveli i varfërisë, pozicioni në punësim dhe arsimim, nevojat për shërbime të bazuara në komunitet dhe çështje të tjera. VKM. Nr. 708 Datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, përveç detyrimit të të gjitha institucioneve për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të disagreguara për PAK, parashikon kryerjen e anketimeve të dedikuara për PAK kryesisht nga INSTAT. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshihen në zbatimin e këtyre lloj anketash dhe nismave të tjera kërkimore.

Në fushën e kujdesit social, ka një vendim të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e **regjesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të ndihmës shoqërore për përfitimet e personave me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore**⁵⁶. Vendimi përcakton llojin dhe shpeshësinë e mbledhjes së të dhënave dhe linjat e qarta të raportimit. Në të kërkohet edhe “**vlerësimi i ndikimit të politikave** në uljen e varfërisë, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta”, edhe pse ky lloj aktiviteti është aktualisht i kufizuar. Monitorimi i politikave publike bazohet gjerësisht në grumbullimin e të dhënave administrative. Në Strategjinë për Mbrojtjen Sociale, qeveria u angazhua të rrisë transparencën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të përfituar pagesat e aftësisë së kufizuar përmes sistemeve të të dhënave dhe zhvillimit të një Sistemi Informativ të Integruar të Menaxhimit⁵⁷.

Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale, 2015-2020, përshkruan një plan të mirëdetajuar

⁵⁵ Qeveria e Shqipërisë, *Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale, 2015-2020*, f. 131.

⁵⁶ VKM nr. 617, datë 7 shtator 2006, “Për përcaktimin e regjesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore”, i rishikuar.

⁵⁷ Qeveria e Shqipërisë, *Strategjia për Mbrojtjen Sociale dhe Plani i Veprimit, 2015-2020*.



për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave. Ai specifikon se “**standardet e të dhënave** do të rishikohen me shpejtësi dhe do të përditësohen nga një Grup i Treguesve dhe Integritetit të Statistikave (GTIS) me qëllim që treguesit e përfshirjes sociale të Shqipërisë të kenë rëndësi dhe të jenë të ndjeshëm në kontekstin vendor, duke qenë në përputhje të plotë me standardet e BE-së, dhe të integruar me sistemin e mbrojtjes shoqërore të BE-së për sistemet statistikore (ESSPROS) ”⁵⁸.

Statistikat ekzistuese nuk japin një klasifikim të detajuar të familjeve sipas kriterëve të ndryshme ose nuk lejojnë referimin e kryqëzuar të disa kriterëve të shpërndarjes (p.sh. shpërndarje e detajuar sipas moshës, shpërndarje sipas gjinisë, personave me aftësi të kufizuara, tablosë sipas llojeve të familjeve, sipas qarkut/bashkisë, nivelit arsimor dhe përkatësisë etnike). Kjo vazhdon të jetë e vërtetë pavarësisht përpjekjeve për të përmirësuar kuadrot model, si dhe për të përgatitur dhe për të hartuar statistika specifike përshkruese për gjininë, minoritetet etnike dhe aftësinë e kufizuar⁵⁹. Për të trajtuar këto çështje, Grupi Tematik për Përfshirjen Sociale (brenda Grupit Qeveritar për Menaxhimin e Integruar të Politikave - Punësimi, Aftësitë dhe Politikat Sociale) do të vendosë GTIS-në për të garantuar respektimin e standardeve të të dhënave⁶⁰ për të gjithë treguesit në nivel BE-je dhe në nivel kombëtar⁶¹.

Qeveria ka sisteme dixhitale për menaxhimin e të dhënave administrative, edhe pse sektorë të ndryshëm shpesh nuk janë të lidhur (si për shembull, sistemi me informacionin për invalidët e punës nuk është i lidhur me sistemin që përdoret nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit). Një sistem i unifikuar, të paktën për fushat e kujdesit social, punësimit, AFP-së, arsimimit dhe shëndetësisë (ose të paktën disa prej këtyre segmenteve) do të lehtësonte përfshirjen e modelit bio-psiko-social dhe do t’i mundësonte qeverisë që t’i përgjigjej më mirë nevojave të çdo individi.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve në zbatimin dhe në mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave. Duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat me aftësi të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile janë në vendin e duhur për të mbajtur shënim mësimet e marra nga zbatimi i politikës dhe për t’u shpjeguar pjesëmarrësve të mundshëm rëndësinë e mbledhjes së të dhënave.

58 Qeveria e Shqipërisë, *Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale, 2015-2020*, f. 4.

59 INSTAT (2015), *Profili i Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri*, janar 2015.

60 Do të organizohet një konsultim me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të diskutuar politikën për mbrojtjen e të dhënave.

61 Qeveria e Shqipërisë, *Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale, 2015-2020*, f. 42.

Treguesit e monitorimit

Sektoret	Treguesit	Institucionet raportuese	Njesi matje	Burimi	Vlera e fundit e vlefshme		Synimi 2017	Synimi 2020	Periodiciteti
					Viti	Vlera	Vlera	Vlera	
Aksesueshmëria	Përqindja e institucioneve qendrore që kanë miratuar planin e aksesueshmërisë dhe kanë planifikuar fondet e duhura.	Të gjitha institucionet	%	Të gjitha institucionet	2013	2%	50%	100%	Vjetore
Aksesueshmëria	Numri i qendrave te votimit te aksesueshme ne zgjedhjet elektorale.	KQZ	%	KQZ	2013	15%	60%	80%	Vitet e zgjedhjeve elektorale
Aksesueshmëria	Numri i PAK që marrin pjesë në procesin e votimit.	KQZ	%	KQZ	2013	N/A	20%	50%	Vitet e zgjedhjeve elektorale
Aksesueshmëria	Numri i qendrave të AFP-së që përdorin mjete komunikimi dhe informimi dhe që kanë prezantuar përshtatje arkitekturore.	MMSR	Numer fizik	MMSR	2013	3 qendra AFP te pershtatura	6 qendra AFP te pershtatura	10 qendra AFP te pershtatura	Vjetore
Punësimi dhe Aftësimi	Numri i mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së të trajnuar mbi mësimdhënien për grupet e PAK.	MMSR	Numer fizik	MMSR	2013	0	1/ për cdo qendër	2/ për cdo qendër	Vjetore
Punësimi dhe Aftësimi	Numri i personave me aftësi të kufizuar që përfitojnë nga kurset falas të AFP-së.	MMSR	%	MMSR	2013	113	50% rritje	100% rritje	Vjetore



Punësimi dhe Aftësimi	Rritja e punësimit të PAK nëpërmjet programeve të punësimit	MMSR	Numer fizik	MMSR	2013	79	150	300	Vjetore
Punësimi dhe Aftësimi	Trajnimi i specialistëve të punësimit për intervistimin dhe ndërmjetësimin e PAK	MMSR	Numer fizik	MMSR	2013	0	80	200	Vjetore
Arsimi	Ngritja e Komisioneve Multidisiplinare të Arsimit për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.	MAS	Numer fizik	MAS	2013	0	6 qarqe	10 qarqe	Vjetore
Arsimi	Numri i mësuesve ndihmës të caktuar në përputhje me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara	MAS	Numer fizik	MAS	2013	0	100	200	Viti shkollor
Arsimi	Numri i mësuesve ndihmës të trajnuar	MAS	Numer fizik	MAS	2013	0	50	150	Viti shkollor
Kujdesi Social	Numri i anëtarëve të personelit që ofrojnë shërbime shoqërore të trajnuar për të aplikuar në mënyrën e duhur shërbimin e përshtatshëm për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuara	MMSR SHSSH	Numer fizik	MMSR SHSSH	2013	0	50	100	Vjetore

Kujdesi Social	Rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara që jetojnë në familje kujdestare	MMSR SHSSH	Numer fizik	MMSR SHSSH	2013	18	50	100	Vjetore
Kujdesi Social	Trajnim i ekipeve multidisiplinare të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për t'i aftësuar ata të vlerësojnë nevojat e individëve me aftësi të kufizuara	MMSR SHSSH	Numer fizik	MMSR SHSSH	2013	0	30	100	Vjetore
Shëndetsia dhe kujdesi social	Numri i sportistëve profesionistë me aftësi të kufizuara që marrin shërbime rehabilitimi	MSH	Numer fizik	MSH	2013	2	5	10	Vjetore





6

Matrica e Planit të Veprimit

6. MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT

Fusha e politikave: AKSESUESHMËRIA

Qëllimi strategjik: Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara

Objektivi 1: Përmirësimi i aksesueshmërisë fizike në shërbimet publike për personat me aftësi të kufizuara

Synimi në nivel objektiv: Rritje në çdo sektor e shërbimeve publike të aksesueshme fizikisht

Aktivitetet	Treguesit	Baza e referimit	Objektivat 2017	Objektivat 2020	Burimi i të dhënave	Organi përgjegjës	Monitorimi /raportimi	Afati kohor	Buxheti		
									Qeveria e Shqipërisë	Donatorët	Totali
1.1 Kryerja e një trajnimi të të gjitha pikave të kontaktit në nivel qendror dhe vendor për çështjet e aftësisë së kufizuar në aspekte të ndryshme të aksesueshmërisë	Numri i pikave të kontaktit që janë trajnuar	Jo të gjitha pikat e kontaktit për çështjet e aftësisë së kufizuar janë emëruar zyrtarisht dhe ata nuk kanë kryer trajnime rreth aksesueshmërisë	Trajnimi i të gjitha pikave të kontaktit në fund të vitit 2017	Zhvillimi i një trajnim vijues në fund të vitit 2018 (më i avancuar, por që garanton gjithashtu që ndryshimet në staf nuk do të ulin shkallën e kapaciteteve)	Materiali i trajnimit për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)	MMSR në bashkëpunim me ministrinë respektive	MMSR	2016-2017 për trajnimin e parë 2018 për trajnimin e avancuar	Nuk ka buxhet	Leke 2,000,000 USD 16.000	Leke 2,000,000 USD 16.000
1.2 Rishikim i Ligjit për Prokurimin Publik në mënyrë që gjithë mallrat dhe shërbimet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara; në prokurimin e shërbimeve sociale, përparësi t'i jepet cilësisë më shumë se koston së ulët.	Vlerësim i Ligjit për Prokurimin Publik, për mundësinë e përfshirjes së kriterëve për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara	Mallrat dhe shërbimet nuk mbajnë parasysh specifikimet teknike për personat me aftësi të kufizuara	Vlerësim i perfunduar shoqëruar me propozimet perkatëse		Teksti i Ligjit për Prokurimin Publik	MMSR/ Agjencia për Prokurimin Publik	MMSR/ Agjencia për Prokurimin Publik	2017	Pa kosto	Cdo financim shtesë do të ndihmonte për të rritur shtrirjen ose për të përmirësuar cilësinë e këtij aktiviteti	Pa kosto

1.3 Kryerja e një kontrolli të aksesueshmërisë në të gjitha ambientet e Drejtorive të Policisë në të gjithë territorin e vendit dhe përdorimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë	Kryerja dhe publikimi i rezultateve të kontrollit Plani i përmirësimit të aksesueshmërisë dhe buxheti i miratuar	Ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme po rikonstruohenduke patur në fokus aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2016	Miratimi dhe financimi me buxhet i planit për përmirësimin e aksesueshmërisë në fund të vitit 2018	Raporti i MBI kontrollit të aksesueshmërisë Dokumentet e MB të planit dhe buxhetit të përmirësimit të aksesueshmërisë	MMSR + MB	MMSR + MB	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2017 Miratimi i planit me buxhetin në fund të vitit 2018	Nuk ka buxhet në dispozicion	1,300,000 LEK (10,000 USD)	1,300,000 LEK (10,000 USD)
1.4 Hartimi dhe aprovimi i nje plani i cili do te ndihmojë NjQV gjate rikonstruksionit te te gjitha institucioneve edukuese ne te gjithë Shqiperine	Numri i institucioneve parashkollore, ato të arsimit bazë (fillor dhe të mesëm të ulët), të mesëm të lartë dhe universiteteve publike të cilat kanë adoptuar ndërtesat në përputhje me standardet e aksesueshmërisë.	Plani nuk ekziston	Plani zhvillohet ne fund te 2016	-	Raportet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve	MAS	MAS	2016	Pa kosto	Cdo financim shtesë do të ndihmonte për të rritur shtrirjen ose për të përmirësuar cilësinë e këtij aktiviteti	Pa kosto

1.5 Kryerja e një kontrolli të aksesueshmërisë në Drejtorinë Rajonale Arsimore dhe shfrytëzimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë	Kryerja e një kontrolli të aksesueshmërisë në njësitë arsimore vendore (Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore) dhe shfrytëzimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë.	Ambientet e MAS po rikonstruktohen duke patur në fokus aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2016	Miratimi dhe financimi me buxhet i planit për përmirësimin e aksesueshmërisë në fund të vitit 2018	Raportim përndryshimet lidhur me aksesueshmërisë Dokumentet e planit dhe buxhetit të përmirësimin të aksesueshmërisë	MAS	MAS	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2016 Miratimi i planit me buxhetin në fund të vitit 2017	Nuk ka buxhet në dispozicion	1,300,000 LEK (10,000 USD)	1,300,000 LEK (10,000 USD)
1.6 Kryerja e një kontrolli të aksesueshmërisë në të gjitha mjediset për të cilat MMSR është përgjegjëse dhe shfrytëzimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë	Kryerja dhe publikimi i rezultateve të kontrollit Plani i përmirësimin të aksesueshmërisë dhe buxheti i miratuar	Godina kryesore e MMSR-së është pjesërisht e aksesueshme, por nuk ndodh kështu me të gjitha mjediset	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2016	Miratimi dhe financimi me buxhet i planit për përmirësimin e aksesueshmërisë në fund të vitit 2017	Raporti i MMSRi kontrollit të aksesueshmërisë Dokumenteplanit dhe buxhetit të përmirësimin të aksesueshmërisë	MMSR	MMSR	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2016 Miratimi i planit me buxhetin në fund të vitit 2017	Nuk ka buxhet	1,300,000 LEK (10,000 USD)	1,300,000 LEK (10,000 USD)
1.7 Sigurimi që mjediset e saporikonstruktuar të Ministrisë së Zhvillimit Urban janë të aksesueshme	Trajtimi i elementëve të aksesueshmërisë në rikonstrukcionin e mjedisëve të MZHU (në proces)	Rikonstrukcioni është në proces dhe plani i zhvilluar në përputhje me standardet e aksesueshmërisë	Rikonstrukcioni i kryer në përputhje me standardet e aksesueshmërisë në fund të vitit 2016	-	Raportet e MZHU-së	MZHU	MZHU	2016	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto

1.8 Kryerja e një kontrolli të aksesueshmërisë së infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe krijimi i aksesit maksimal të mundshëm fizik për personat me aftësi të kufizuara	Kryerja dhe publikimi i rezultateve të kontrollit Numri i ndërtesave të sistemit të drejtësisë që janë përshtatur për të siguruar aksesin maksimal të mundshëm për personat me aftësi të kufizuara	Pjesa më e madhe e ambienteve të sistemit të drejtësisë nuk janë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara dhe nuk ekziston asnjë plan për përmirësimin e situatës	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2017	Përfundimi i masave për maksimizimin e aksesueshmërisë në infrastrukturën e sistemit të drejtësisë në fund të vitit 2020	Raporti i MD i kontrollit të aksesueshmërisë Planet dhe raportet e MD për përmirësimin e aksesueshmërisë	MD, Zyra për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor	MD, Zyra për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor	Publikimi i kontrollit të aksesueshmërisë në fund të vitit 2017 Miratimi i planit me buxhetin në fund të vitit 2018	Nuk ka buxhet në dispozicion	1,300,000 LEK (10,000 USD)	1,300,000 LEK (10,000 USD)
1.9 Kryerja e një kontrolli të aksesueshmërisë në Ministrinë e Kulturës dhe institucionet kulturore (prania e platformave të pjerrëta/ashensorëve, banjat e aksesueshme dhe kërkesa të tjera) dhe përdorimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë	Kryerja e kontrollit të aksesueshmërisë dhe përdorimi i tij për të zhvilluar një plan për përmirësimin e aksesueshmërisë në institucionet kulturore	Nuk është kryer kurrë kontroll aksesueshmërie	Kryerja e një kontrolli aksesueshmërie në vitin 2016	Nuk ka	Raporti i kontrollit të aksesueshmërisë	Ministria e Kulturës (MK), Drejtoria e Krijimit dhe Edukimit përmes Kulturës, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe Muzeve	MK, Drejtoria e Krijimit dhe Edukimit përmes Kulturës, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe Muzeve	2017	Nuk ka buxhet në dispozicion	650,000 LEK (5,000 USD)	650,000 LEK (5,000 USD)

1.10 Te gjitha qendrat shendetësore dhe institucionet e Fondit të Kujdesit Shëndetësor të përmirësojnë infrastrukturën duke u adaptuar sipas nevojave të PAK-ut (Rampa, tualete, sinjalistika per personat e verber)	% e qendrave shëndetësore kanë përmirësuar infrastrukturën	Asnjë i rinovuar deri tani	Infrastruktura e përmirësuar ne 40% te qendrave shendetësore	Infrastruktura e përmirësuar ne 80% te qendrave shendetësore	Raporte te MSH	MSH	MSH	2016-2020	LEK 83 million (USD 640,000)	Cdo financim shtesë do të ndihmonte për të rritur shtrirjen ose për të përmirësuar cilësinë e këtij aktiviteti	LEK 83 million (USD 640,000)
1.11 Ofrimi i aksesit fizik në qendrat ku ofrohet shërbimi rehabilitues.	Numri i qendrave me aksesueshmeri fizike ku ofrohet shërbimi i rehabilitimit.	Qendrat ku ofrohen shërbime rehabilitimi nuk janë fizikisht të aksesueshme	Aksesibiliteti i përmirësuar ne 40% te qendrave ku ofrohen shërbimet e rehabilitimit.	Aksesibiliteti i përmirësuar ne 80% te qendrave ku ofrohen shërbimet e rehabilitimit	Raporte te MSH	MSH	MSH	2016-2020	Mbulohet tek aktiviteti 1.10	Cdo financim shtesë do të ndihmonte për të rritur shtrirjen ose për të përmirësuar cilësinë e këtij aktiviteti	Mbulohet tek aktiviteti 1.10
1.12 Mundësimi i aksesit maksimal të mundshëm fizik për personat me aftësi të kufizuara në një numër në rritje të zyrave të punësimit (platforma, ashensorë, banja, shenja drejtuese për personat që kanë probleme me shikimin)	Numri i zyrave të aksesueshme të punësimit	Një numër i vogël zyrash të SHKP-së janë pjesërisht të aksesueshme. Disa kanë probleme pronësie dhe nuk mund t'i modifikojnë ndërtesat	2 zyra të reja të aksesueshme të SHKP-së	5 zyra të aksesueshme të SHKP-së në total	Raportet e Departamentit të Punësimit në MMSR	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	Viti 2017 për 2 zyrat Viti 2020 për 5 zyrat	LEK 1 million (USD 8,000)	Cdo financim shtesë do të ndihmonte për të rritur shtrirjen ose për të përmirësuar cilësinë e këtij aktiviteti	LEK 1 million (USD 8,000)

1.13 Organizimi i ndërtimit dhe vendosja e platformave të lëvizshme nga studentët e shkollave profesionale	Numri i platformave të lëvizshme të ndërtuara dhe të vendosura në institucionet publike nga studentët e shkollave profesionale	Nuk është ndërtuar asnjë platformë nga studentët e shkollave profesionale	Ndërtimi dhe vendosja e 50 platformave në institucionet publike (para-shkollorë, universitete, qendra të AFP-së, zyra të SHKP-së, ministri, bashki etj.)	Ndërtimi dhe vendosja e 100 platformave	Raportet e Departamentit të AFP-së së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)	Departamenti i AFP-së në MMSR	Departamenti i AFP-së në MMSR	2017 për 50 platforma 2020 për 100 platforma	LEK 10 million (USD 77,000)	Cdo financim shtesë do të ndihmonte për të rritur shtrirjen ose për të përmirësuar cilësinë e këtij aktiviteti	LEK 10 million (USD 77,000)
